



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2023 DERI 30.06.2022, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
OBJEKTEVE PUBLIKE, BASHKIA TIRANË”**

Tiranë 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje.....	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit	5
I/4. Metodologjia e Auditimit.....	5
I/5. Konkluzioni.....	6
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË OBJEKTEVE PUBLIKE, BASHKIA TIRANË	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	29



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në 6 subjekte, respektivisht: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Njësia Administrative Dajt, Njësia Administrative Petrelë, Njësia Administrative Farkë dhe Njësia Administrative Zall-Herr (Bashkia Tiranë): “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve:

DPOP, ka kthyer përgjigje brenda afatit të 20 ditëve në KLSH me shkresën nr. 1008/10, datë 24.04.2023 për planin e masave në zbatim të rekomandimeve.

- Nga 28 masa organizative, të cilat janë pranuar nga subjekti, janë zbatuar 18 masa, 9 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht;
- 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 232,320 lekë pranuar nga subjekti, është zbatuar plotësisht;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën 134,744,012 lekë, të cilat janë pranuar nga subjekti, janë zbatuar pjesërisht;
- 7 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

I/1. Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 191/7 prot., datë 20.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 25.03.2024, u krye auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R.K - Përgjegjës grupi
2. E.K - Anëtare
3. F.Ç - Anëtar
4. M.M - Anëtar

Cështjet e Audituarra:

1. Hartimi i programit (*Plan veprimit*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësisë dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në DPOP me shkresën nr. 1007/8, datë 28.03.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se DPOP kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e 28 rekomandimeve organizative, 1 masë për shpërblim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike dhe 7 masa disiplinore të lëna, të cilat janë pranuar nga DPOP.

Masa organizative

Nga 28 masa organizative, janë zbatuar 18 rekomandime, 9 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Masa për shpërblim dëmi

Nga 1 masë për shpërblim dëmi, është zbatuar 1 masë.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike

Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, janë zbatuar pjesërisht të dy masat.

Masa Disiplinore

Nga 7 masa disiplinore të lënë, janë zbatuar rekomandimet për të 7 punonjësit.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË OBJEKTEVE PUBLIKE, BASHKIA TIRANË

1. Auditimi i fundit në Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

Auditimi i fundit në DPOP është kryer në vitin 2023 për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr.1007/8prot., datë 28.03.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 28 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masë për shpërblim dëmi, në vlerë 232,320 lekë, pranuar nga subjekti;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerë 134,744,012 lekë, pranuar nga subjekti;
- 7 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, DPOP duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, DPOP për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr.1007/8 prot., datë 28.03.2023 **ka kthyer përgjigje** në KLSH me shkresën nr. 1008/10, datë 24.04.2023 brenda afatit ligjor prej 20 ditës, por rezulton se është hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 1007/8 prot., datë 28.03.2023, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”. Sipas verifikimit DPOP **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se DPOP ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1007/8 prot., datë 28.03.2023, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësive (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: *5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësive së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësive.*

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në DPOP

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar DPOP 28 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: DPOP Tiranë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk është krijuar GMS dhe caktuar koordinatori i riskut, nuk janë miratuar regjistrat e konsoliduar të riskut, nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar plane vjetore trajnimesh për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit edhe në programe trajnimesh të organit epior bashkia Tiranë; mungesa e GMS ka sjellë mungesën e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të njësive, planeve dhe raporteve vjetore mbi problematikat që hasen dhe parashikim për zgjidhjen e tyre gjatë veprimtarisë së njësive publike. Mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2 dhe Manuali MFK miratuar nga Ministri MFE me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinatorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve dhe regjistrin e konsoliduar të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët standarde të auditimit me qëllim menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve në aktet ligjore/nënligjore dhe hapjen e faqes zyrtare në internet të DPOP Tiranë.

Në vijimësi

1.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masa për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm për vitin 2023 me Nr.61 prot, datë 09.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës të menaxhimit strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe rolit të tij në sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, dhe për vitin 2024 me Nr.300 prot., datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës të menaxhimit strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe rolit të tij në sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” si dhe Urdhëri i Brendshëm Nr. 66 prot. datë 09.01.2023 “Për ngritjen e grupit të monitorimit të përgjithshëm që lidhet me sistemin financiar dhe kontrollin e brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike”.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 66/2023 janë marrë masat për përcjelljen e relacionit nga ana e grupit të Menaxhimit të Riskut me Nr. 66/1 prot., datë 02.10.2023 si dhe Relacioni me Nr.66/2 prot., datë 01.12.2023.

Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka marrë masat për hartimin e Gjurmës së Auditit për prokurimet me vlerë mbi 800,000 (tetëqind mijë) Lekë pa TVSH dhe Gjurmët e Auditit për Prokurimet me vlerë të vogël nën 800,000 (tetëqind mijë) Lekë pa TVSH, përcjellë me shkresën Nr.4815/6 prot., datë 26.12.2023 me lëndë: “Përcjellje e Kontrollit të Brendshëm, analizës vjetore të punës dhe regjistrin vjetor të riskut për vitin 2023 si dhe parashikimin e planit vjetor të punës për vitin 2024 për Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës.

Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me anë të shkresës Nr. 1673/2 prot. datë 29.05.2023, ka marrë masat për përcjelljen e shkresës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave, Bashkia Tiranë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Medias dhe Komunikimit pranë Bashkisë Tiranë lidhur me hapjen e faqës zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike.

Rekomandimi është zbatuar

1.2 Rekomandim: Drejtoria e Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të marrë masa për të hartuar plane vjetore trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

1.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, nga DPPGj janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm Nr. 617 prot., datë 13.02.2023 “Për ndjekjen e trajnimeve referuar kalendarit të ofron Shkolla Shqiptare e Administratës Publike” dhe Urdhëri i Brendshëm Nr.723 prot., datë 13.02.2024” Për ndjekjen e trajnimeve referuar kalendarit të ofron Shkolla Shqiptare e Administratës Publike”. Çdo kalendar trajtimi që është përcjellë nga ana e Bashkisë Tiranë apo Shkolla e Administratës Publike ju është përcjellë për ndjekje specialistëve sipas interesit dhe fushës së veprimtarisë. Në këtë kuadër është mbajtur kalendari i trajnimeve, ku përcaktohen temat, datat si dhe lektorët pjesëmarrës në trajnim.

Referuar shkresës me Nr. 1673/1 prot., datë 29.05.2023, të gjitha dosjet e personelit janë plotësuar me dokumentacionin përkatës sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi nga Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës.

Rekomandimi është zbatuar

1.3 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të ofrojë me përgjegjshmëri mbështetje të Nëpunësi Autorizues, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi, konform akteve ligjore/nënligjore për arritjen e objektivave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.3 Nga verifikimi rezultoi se, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 1475 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.3 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Ekonomike ka ngritur grupin e monitorimit të përgjithshëm që lidhet me sistemin financiar dhe kontrollin e brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 66, datë 09.01.2023, bashkëlidhur relacioni Nr. 66/2023 dhe Relacioni me Nr.66/2 prot., datë 01.12.2023.

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mosrealizimit të planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore konstatohet se:

1. Referuar të dhënave të pasqyrës së planifikimit e realizimit për çdo zë buxhetor, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 52.7% deri në 100% për vitin 2020, nga 76,4% deri 98% për vitin 2021, nga 56 % deri 99.2% për vitin 2022; por gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit për llog. 600, llog. 601 dhe llog. 606 vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022, ndërsa niveli i realizimit të po këtyre zërave vjen në rënie (përrjashtuar llog. 600-601); për llog. 602 dhe llog. 230-231 niveli i planifikimit vjen në rënie ndërsa niveli i realizimit vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe në rënie për vitin 2022, Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka DPOP dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2020 e zënë shpenzimet për llog. 602 e ndjekur nga llog. 600-601, për vitin 2021 e zënë shpenzimet e llog. 600 –601 e ndjekur nga llog. 602; edhe për vitin 2022 peshën specifike e zë llog. 600-601 e ndjekur nga llog. 602. Kjo tregon një rritje të planifikimit të shpenzimeve për zërin buxhetor “paga personeli” për shkak të trendit në rritje që paraqet planifikimi dhe realizimi për rekrutime si dhe për një planifikim të vlerave buxhetore në rënie për investime.

2. Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit e të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave nga bashkia dhe shpenzimeve të tyre, që do të thotë se nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

realizuara, ka diferenca të dukshme të cilat janë pasqyruar edhe në tabelë, duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie.

3. Referuar tabelës së Investimeve rezultoi se, realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta: *për vitin 2019* është realizuar në vlerën e 206,201,487 lekë; *në vitin 2020* në vlerën e 163,946,286 lekë ose 52.7% e fondeve të planifikuara dhe me një diferencë prej 42,255,201 lekë më pak nga viti 2019; ndërsa *për vitin 2021* realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 184,578,149 lekë ose 71.7% e fondeve të planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të lartë realizimi se ajo në vitin 2020 me (+)20,631,863 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2020; ndërsa *për vitin 2022* realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 84,248,231 lekë ose 56.2% e fondeve të planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të ulët realizimi se ajo në vitin 2021 me (-)100,329,918 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2021;

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia dhe njësitë e varësisë nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

4. Lidhur me detyrimet e prapambetura nga auditimi rezultoi se: likuiditeti i detyrimeve të prapambetura në total për “investime nga bashkia” dhe “mallra e shërbime” të marra së bashku, është i vogël por ka trend në rritje; situatën e përkeqëson krijimi i detyrimeve të reja për këta zëra buxhetorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse të buxhetit në bashkinë Tiranë, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Bashkia Tiranë është në kontakt të vazhdueshëm me strukturat e Bashkisë Tiranë për realizimin e buxhetit dhe shpenzimeve përkatëse sa më të sakta për periudhat e vitit 2024-2026, referuar shkresës së përcjellë nga Drejtoria Ekonomike me Nr. 3247 prot., datë 30.08.2023.

Rekomandimi është në proces

2.2 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike pranë DPOP, Bashkia Tiranë, të marrë masa për likuidimin në kohë të detyrimeve vjetore ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu në planifikimin e buxhetit, më parë të planifikohen fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndërsa vite, sipas një plani të miratuar, me qëllim uljen në maksimum të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

2.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1477 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.5 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Drejtorisë Ekonomike ndiqet në mënyrë rigoroze Udhëzimi i Ministrisë së Financave lidhur me likuidimin e faturave deri në 60 ditë kalendarike nga data e faturimit (bashkëlidhur Urdhër Shpenzimet), referuar shkresës së përcjellë nga Drejtoria Ekonomike me Nr. 3247 prot., datë 30.08.2023.

Rekomandimi është në proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin e buxhetit sipas nevojave institucionale konstatohet se:

1. Nga auditimi rezultoi se, nuk janë ngritur dhe miratuar GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për DPOP Tiranë, të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), politikat që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-se, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës. Kjo ka sjellë që procesi i hartimit dhe miratimit të PBA –ve, të në mos kalojë në të gjitha hallkat përkatëse, duke mos zbatuar kështu udhëzimet e MFE/Drejtoria e Financave Vendore: Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 7 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”. **2.** Për diskutimet rreth hartimit dhe prezantimit të PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxheti Vjetor 2021, nga ana e DPOP nuk ka asnjë takim të dokumentuar me njësitë përbërëse të strukturës së saj, apo dhe të DPOP me organin epror Bashkia Tiranë (takime me prezencë apo në platformën on-line), në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

3. Plani i buxhetit të DPOP Tiranë në raport me planin e buxhetit të Bashkisë Tiranë, rezulton të jetë: për vitin 2020 plani fillestar i buxhetit të DPOP zë 5.2% të planit të Bashkisë Tiranë dhe 4.1 % ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2021 zë 6.1 % të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2022 zë 4.7% të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar. Pra vlera e raportit të planit buxhetor të ndryshuar të DPOP ndaj atij të Bashkisë Tiranë vjen në rënie; Kjo ka sjellë që me zgjerimin e kompetencave dhe të fushës së veprimtarisë së DPOP Tiranë nga ana e Bashkisë Tiranë, të mos jetë në raport të drejtë me planifikimin e fondeve buxhetore vjetore, me qëllim realizimin me efektivitet të shërbimeve nga ana e njësisë publike. Kjo në moszbatim të ligjit nr.9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 29-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Në DPOP Tiranë titullari i saj në cilësinë e NA të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik për realizimin e takimeve, ku të analizohet çdo tregues i mos/realizimit të buxhetit vjetor, të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato mallra e shërbime që janë pjesë e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së njësisë nga njëra anë dhe arritjes së objektivave të saj nga ana tjetër, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Në vijimësi

3.2 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm për vitin 2023 me Nr.61 prot, datë 09.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës të menaxhimit strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe rolit të tij në sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, dhe për vitin 2024 me Nr.300 prot, datë 19.01.2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

“Për ngritjen e grupit të punës të menaxhimit strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe rolit të tij në sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 66/2023 bashkelidhur relacionit me Nr. 66/1 prot. Datë 02.10.2023 dhe Relacioni me Nr.66/2 prot. Datë 01.12.2023.

Rekomandimi është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se:

1. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,337,156 lekë. Në këtë llogari nuk është përfshirë shuma prej 108,432 lekë e cila përfaqëson detyrimin për shërbimet e 3 automjeteve, shumë e cila përfshihet në llog. 467 të pasivit. Pra kjo llog. është nënvlerësuar për shumën 108,432 lekë; kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

2. Në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet **llog. 470** “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” në vlerën 100,689,492 lekë me kundër-parti llog.468, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar; kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

3. Përsa i përket objekteve të cilat janë në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe i kanë kaluar për mirëmbajtje DPOP Tiranë, të cilat aktualisht janë të pasqyruara në bilancin kontabël të datës 31.12.2020 dhe 31.12.2021, referuar regjistrin të aseteve: disa figurojnë me çmimin e blerjes, disa nuk anë vlerë apo vitin kur janë krijuar. Gjykojmë se pasqyrimi i zërave me vlerat e viteve kaq të largëta nuk japin një pamje reale të vlerës së ndërtesave dhe rrjedhimisht nuk pasqyrojnë vlerën aktuale të tregut. Nga regjistri i Aseteve rezultojnë 53 (pesëdhjetë e tre) objekte që nuk e kanë vlerën e objektit (godinës) por janë kontabilizuar me vlerën e investimit të kryer mbi to. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Pra rezulton se vlera e **llog. 212** në kontabilitet nuk pasqyron vlerën reale të objekteve;

4. Nga regjistri i aktiveve të njësisë për periudhën nën auditim, rezultojnë 51 mjete transporti, ku përfshihen edhe 7 (shtatë) mjete tejet të amortizuara teknikisht dhe që janë vlerësuar në pamundësi qarkullimi në rrugë (referuar praktikës dokumentare të komisionit së inventarizimit. Vlera kontabël në total e tyre është 11,270,000 lekë. Këto mjete nuk i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, në moszbatim kjo të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke bërë që vlera e tyre të gjendet në mënyrë të gabuar e pasqyruar në vlerën e llog. 215 në kontabilitet, duke pasqyruar një vlerë jo reale të kësaj llogarie, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

5. Në **llog. 602** nuk është pasqyruar vlera e nënllogarisë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë për vitin 2021, e cila përfaqëson shpenzimin e 12 muajve për ambiente (magazina) të marra me qira nga DPOP Tiranë. Pra rezulton se llog. 602 është nënvlerësuar në shumën 26,492,956 lekë, që përfaqëson shpenzime qiramarrje të ambienteve, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandim Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të sistemuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 486 për shumën 108,432 lekë;

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

4.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, Referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 1479 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.7 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Drejtorisë Ekonomike janë marrë masat për sistemimin e shumës 108,432 lekë fatura e tre shërbimeve të automjeteve. Ky detyrim është regjistruar në pasqyrat financiare në bilancin e institucioni. Është regjistruar në pasiv në nënllogarinë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 108,432 lekë, referuar shkresës së përcjellë nga Drejtoria Ekonomike me Nr. 3247 prot., datë 30.08.2023.

Rekomandimi është zbatuar

4.2 Rekoamndim: Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të plotësuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 602 në nënllogarinë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë;

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

4.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 1480 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.8 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Drejtorisë Ekonomike janë marrë masat përse i përket shumës 29,060,777 Lekë që u përket qirave të magazinave. Kjo shumë është regjistruar në nënllogarinë 6026 “Shpenzime për qiramarrje” në pasqyrën financiare të vitit 2022, referuar shkresës së përcjellë nga Drejtoria Ekonomike me Nr. 3247 prot., datë 30.08.2023.

Rekomandimi është zbatuar

4.3 Rekomandim Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës të plotësojë në pasqyrat financiare llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në shumën 100,689,492 lekë;

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

4.2.3 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1481 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.9 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga ana e strukturës përgjegjëse pranë DPOP, janë marrë marrë masat për njoftimin e debitorëve për pagimin e detyrimeve të prapambetura në Banesat Sociale në Shkozë, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 4846 prot., datë 11.12.2023 “Për marrjen e masave për njoftimin e debitorëve, pagimin e detyrimeve të prapambetura në Banesat Sociale në Shkozë”.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 4899 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit me lëndë: “Kërkesë për ngritjen e grupit paraseleksionues, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të përfituesve të Banesave Sociale me qira në Shkozë, ish fonderia Mek”.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës me Nr. 4898 prot., datë 13.12.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Menaxhimit Financiar, me lëndë: “Për parashtrimin e problematikave faktike dhe administrative të Banesave Sociale Shkozë, ish fonderia Mek”.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.4 Rekomandim Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e NA, NZ si menaxheri i Drejtorisë Ekonomike, menaxheri i Drejtorisë së Aseteve dhe ai i Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të DPOP në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për të përmbyllur procesin e nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve të amortizuara me qëllim shkarkimin e tyre nga kontabiliteti në vlerën e 11,270,000 lekë dhe pasqyrimin me vlerë reale të llog. 215 “mjete transporti”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

4.2.4 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1482 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.10 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, janë marrë masat për përcjelljen pranë Bashkisë Tiranë të Memos me Nr. 337/1 prot., datë 14.02.2024 me lëndë: “Informacion për pëfundimin e inventarizimit dhe vlerësimit së bashku me racionin shoqëruar të rezultatit të inventarizimit dhe vlerësimit të mjeteve të transportit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike si dhe kërkesës për miratimin e fillimit të procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit”.

Rekomandimi është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për vlerësimin e aktiveve, rezultoi se:

1. Për vitin 2020:- Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve për 2 shkollat: Gjinnazi “Partizani” dhe “Sabaudin Gabrani”, janë pa nënshkrimin e drejtuesve të shkollave; Mungon nënshkrimi i anëtarit të 4 të komisionit znj. L.Y te relacioni në 2 raste për zbatim të UB. 178/2 dt. 29.05.2021 dhe Relacioni i dt. 24.12.2021; Mungon nënshkrimi i specialistes së Financës (në 2 raste): te kartela e inventarëve për propozim dhe përmbledhëse e inventarëve; Nuk kanë dalë urdhra të brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për procedurën e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0; Për sa më lart nuk janë zbatuar Ligji 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Për vitin 2021:- Për aktivitetin e komisionit të ngritur me Urdhrin e brendshëm-32/2 dt. 18.05.2021 “Për ngritjen e komisioneve për inventarin fizik të aktiveve”, mungon Relacioni i Inventarit Fizik të aktiveve; Procesverbalet e përpiluara nga komisioni i vlerësimit në 3 raste nuk janë origjinale: e Urdhrit të brendshëm-32/2 dt. 18.05.2021 me Relacion dt. 29.09.2021; Urdhrit të brendshëm-32/2 dt. 18.05.2021 me Relacion dt. 01.11.2021; Urdhrit të brendshëm-32/2 dt. 18.05.2021 dhe Relacioni i komisionit mungon; Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit; nga Titullari i njësisë nuk kanë dalë urdhra të brendshëm, për krijimin e komisioneve për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV pika 81;

Për vitin 2022:- Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154/2003 “Për arkivat”, “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

neni 13, Vendimi nr. 4/2017 “Për Miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë” shtojca 1;

2. Mjetet (çiklomotora) me targa C dhe C, janë denoncuar në Drejtorinë e Policisë Tiranë të vjedhur. Për këto mjete nuk janë bërë procedurat e çregjistrimit të përkohshëm pranë DRSHTRR Tiranë me qëllim shmangien e detyrimeve vjetore: taksa e qarkullimit dhe gjoba e kolaudit, zbatimi i së cilës shmang pagesat e panevojshme të cilat çojnë në shpërdorimin e fondeve. E njëjta praktikë duhej ndjekur edhe për mjetin me targë T, i cili nuk rezulton në listën e mjeteve aktivë të njësisë, dhe që nënkupton se detyrimet vjetore janë në rritje progresive me kalimin e kohës. Për sa më lart nuk është zbatuar Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120;

3. Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë në cilësinë e subjektit që përdor, mirëmban dhe pasqyron çdo shpenzim në bilancin e saj për mjetet e transportit, ndonëse në vitin 2021 ka kërkuar pranë bashkisë Tiranë mundësinë e çregjistrimit të përhershëm të mjeteve të amortizuara me vlerë kontabël 11,270,000 lekë, duhet të rikërkojë në mënyrë të vazhdueshme që nga ana e bashkisë Tiranë të mbyllet procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të amortizuara (teknikisht), me qëllim largimin e tyre nga ambientet e DPOP, çuarjen e tyre për skrap dhe për të bërë të mundur shkarkimin e tyre nga kontabiliteti i njësisë. Në moszbatim të Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120;

4. Drejtoria e Transportit në DPOP nuk ka hartuar një regjistër të dhënash mbi informacionin teknik, shpenzimet e detyrueshme vjetore dhe shpenzimet për shërbimet teknike të mirëmbajtjes, me qëllim fleksibilitet në marrjen e informacionit dhe ushtrimin e shërbimit në kohë ndaj mjetit, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /;Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 pika 2 dhe Manualit MFK.

5. Komisioni i Inventarizimit në relacionin përmbledhës ka konkluduar se: njësia publike – DPOP Tiranë ka në mirëmbajtjen e saj 131 objekte (godina) me destinacion të ndryshëm përdorimi nga të cilat 22 (njëzetë e dy) nuk janë de facto të DPOP; Nga këto 17 (shtatëmbëdhjetë) në vlerën kontabël 9,613,267 lekë në total, nuk janë fizikisht nën administrimin dhe mirëmbajtjen e saj (në Llog. 212); ndërsa 5 (pesë) godina përdoren nga DPOP Tiranë për nevojat e saj. Në relacionin e komisioneve të inventarizimit, që prej vitit 2017 është bërë identifikimi i tyre në listën e aktiveve, por në terren ato janë tjetërsuar pasi pronarët e tyre i kanë përfutur dhe i kanë zhvilluar sipas nevojave apo interesave të tyre private. Ndonëse nga ana e Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës në DPOP Tiranë me shkresë zyrtare i është drejtuar ZRPP Tiranë (sot ASHK) për çregjistrimin e tyre nga DPOP Tiranë, nuk ka patur feedback nga ana e tyre për bashkëpunim. Kjo ka sjellë që këto objekte të mbeten në pronësi *de jure* të Bashkisë Tiranë dhe vlera e tyre në kontabilitetin e DPOP Tiranë; në moszbatim të Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120 Ligjit nr. 8744 /2001 “Për transferimin e pronave shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit të MFE nr. 2727/2020 “Mbi zbatimin e ligjit 90/2019 dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”.

6. Gjithashtu në Regjistrin e Aseteve për llog.212 disa objekte (godina) nuk e kanë vlerën e tyre fillestare (të krijimit), por kanë të regjistruar vlerën e investimit të realizuar për mirëmbajtjen e tyre; disa objekte u përkasin periudhave të hershme të krijimit (para viti 1990). Nga auditimi rezulton gjithashtu se 20 (njëzetë) objekte inventarë AAGJM- janë të pajisura me certifikatë pronësie; dhe se të gjitha objektet nuk e kanë aktin e vlerësimit të tyre;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

në moszbatim të Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, Ligji 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit të MFE nr. 2727/2020 “Mbi zbatimin e ligjit 90/2019 dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit.

7. DPOP Tiranë nuk i ka përcjellë zyrtarisht organit epror – Bashkia Tiranë relacionin me listën e objekteve të ‘zëna forcërisht’ nga ish- pronarët e tyre, me qëllim që Drejtoria Ligjore pranë saj t’i drejtohet zyrtarisht ASHK- së Tiranë për çregjistrimin e tyre nga pronësia e DPOP Tiranë, pasi ato rezultojnë të tjetërsuara si nga statusi juridik i pronësisë, ashtu edhe fizikisht apo nga destinacioni i përdorimit (funktionalitetit). Në moszbatim të Udhëzimit nr. 30/2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”;

8. Mungesa e Grupit të Menaxhimit Strategjik ka bërë që njësia të ushtrojë funksionet e veta pa hartuar dhe pa miratuar një strategji dhe një rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale të DPOP si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, që do të rriste efektivitetin në aktivitetin e Drejtorisë së Aseteve, Inventareve dhe Koordinimit; në moszbatim të Ligjit ne. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, Manualit MFK pika 2.2.6; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandim Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të transportit të amortizuara, me qëllim që vlera e llog. 215 të jetë sa më reale dhe të përfaqësojë ato mjete transporti të cilat realisht janë në gjendje teknike për të qarkulluar;

Menjëherë

5.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1483 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.11 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, janë marrë masat për përcjelljen pranë Bashkisë Tiranë të Memos me Nr. 337/1 prot., datë 14.02.2024 me lëndë: “Informacion për pëfundimin e inventarizimit dhe vlerësimin së bashku me relacionin shoqërues të rezultatit të inventarizimit dhe vlerësimin të mjeteve të transportit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike si dhe kërkesës për miratimin e fillimit të procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit”.

Rekomandimi është zbatuar

5.2 Rekomandimi Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për çregjistrimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) objekteve që janë ‘të zëna forcërisht’, për vlerësimin kryesisht të atyre pa vlerë fillestare të krijimit, për pajisjen me certifikatë pronësie të 21 (njëzetë e një) objekteve shkollore, për të pasqyruar një vlerë sa më reale të llog. 212 dhe llog. 210 në kontabilitetin e njësisë.

Në vijimësi

5.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm Nr. 1484 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 12 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar listës së objekteve/pronave në inventar të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike të vëna në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Aseteve, Invenarizimit dhe Koordinimit sipas shkresës me nr.3902/2 prot., datë 29.09.2022, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës i është drejtuar në formë shkresore Agjensisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr.3902/3 prot., datë 30.09.2022 me anë të cilës drejtoria jonë kërkon vënien në dispozicion të gjëndjes juridike të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

objekteve/pronave të konstatuara të zëna nga privatët të të gjithë dokumentacionit që disponon për pronat/objektet, mënyrën dhe dokumnetacionin e fitimit të pronësisë për të tretë (nësë ka). Gjithashtu, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me anë të shkresës me Nr. 1484/1 prot., datë 05.06.2023 është drejtuar përsëri Agjensisë Shtetërore të Kadastrës lidhur me vënien në dispozicion të gjëndjes juridike të objekteve/pronave në përdorim nga privatët që struktura e ngarkuar pranë DPOP ka në inventarin e objekteve/pronave të saj.

Rekomandimi është zbatuar

5.3 Rekomandimi Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre, miratimin e një Rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë

5.2.3 Nga verifikimi rezultoi se, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 1485 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.13 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, janë marrë masat për miratimin e Regjistrit të Riskut për Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike.

Rekomandimi është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimimi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2020 – 31.10.2022 në DPOP Tiranë u konstatua se nga DPOP Tiranë njoftimet për punësim nuk realizohen nëpërmjet komunikimit me mjetet dhe në strukturat përgjegjëse – Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Aftësive; DPOP Tiranë nuk ka hartuar listën e kritereve specifike që u bashkëngjitet kritereve bazë për punësim dhe rrjedhimisht ka punësuar persona që nuk plotësojnë kërkesat profesionale e teknike që kërkon efektiviteti i aktivitetit të njësisë, nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione me status “Grup i veçantë” si dhe lidhur me trajtimin e punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, në moszbatim këto të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 79-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandim: NA dhe Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe e Performancës të marrin masa për të përdorur SHKPA si i vetmi organ përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e njoftimeve për punësim; hartimin e kritereve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të caktojnë në strukturën organizative pozicione për kategorinë ‘grup i veçantë’; si dhe të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, të gjitha këto për motivimin e punonjësve rritjen e efektivitetit të shërbimeve nga ana e tyre në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1486 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 14 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga struktura e vartësisë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/1 prot., datë 29.05.2023. Janë marre masat për zbatimin e këtij rekomandimi duke ngritur një urë komunikimi me AKPA (Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive) ku për të gjitha vendet vakante të krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike bëhet regjistrimi online në faqen zyrtare të kësaj agjencie me specifikat e veçanta që kërkon pozicioni i punës të cilat më pas publikohen.

Rekomandimi është në proces

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për subjektet përfituese të banesave sociale, ka rezultuar mungesë funksionimi e strukturave përgjegjëse dhe bashkëvepruese për menaxhimin e kontratave. Kontratat e lidhura me afat 1 vjeçar, nuk janë rinovuar pas përfundimit të këtij afati. Nuk kanë bashkëpunuar strukturat e ngarkuara sipas VKB-së Nr.109, datë 27.09.2018, pasi Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, Komisionit të Strehimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë, nuk kanë dalë me vendimmarrje për rivlerësimin e mëtejshëm të kriterëve të përfituesve, kusht i cili përcakton edhe rinovimin e kontratave. Konstatohet se disa prej banesave sociale braktisen nga qytetarët përfitues, evidentimi i të cilave nuk bëhet në kohën e duhur, duke krijuar detyrime fiktive. Rezultojnë njëkohësisht 12 familje të akomoduar në këto banesa, familje të cilat nuk janë pjesë e listës sipas VKB-së Nr.28, datë 13.08.2015 dhe VKB-së Nr.44, datë 06.07.2016 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të Banesave Sociale me qira”, për të cilët nuk disponohet asnjë kontratë e lidhur dhe detyrimet bashkëlidhur saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 44-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, në bashkëpunim me strukturat e ngarkuara sipas VKB-së nr. 109, datë 27.09.2018, të marrë masa në drejtim të rivlerësimit dhe rinovimit të kontratave për përfituesit e qirave të banesave sociale, kjo për të përcaktuar edhe detyrimin e duhur të vlerës së qirasë për përfituesit e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1487 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 15 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në Përdorim të Komuniteteve, nëpërmjet shkresës me Nr. 1683 prot., datë 05.05.2023 i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit për zbatimin e rekomandimit të lënë.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 4899 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit me lëndë: “Kërkesë për ngritjen e grupit paraseleksionues, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të përfituesve të Banesave Sociale me qiranë të Shkozë, ish fonderia Mek”.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës me Nr. 4898 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, me lëndë: “Për parashtrimin e problematikave faktike dhe administrative të Banesave Sociale Shkozë, ish fonderia Mek”.

Rekomandimi është zbatuar

7.2. Rekomandimi: Për 12 familjet të cilat janë strehuar në banesat sociale të cilët nuk janë pjesë e listës së miratuar me VKB, t'i nënshtrohen procedurave përkatëse nëse e përfitojnë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

ose jo banesën sociale. Të evidentohen me procesverbalin përkatës nëpërmjet strukturave të ngritura pranë kësaj drejtorie, largimet/braktisjet e banesave nga përfituesit e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1488 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 16 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Administrimit të Banësive Sociale dhe Banësive në Përdorim të Komuniteteve, Për 12 familjet të cilat janë strehuar në banesat sociale të cilët nuk janë pjesë e listës së miratuar me VKB, t’i nënshtrohen procedurave përkatëse nëse e përfitojnë ose jo banesën sociale. Të evidentohen me procesverbalin përkatës nëpërmjet strukturave të ngritura pranë kësaj drejtorie, largimet/braktisjet e banesave nga përfituesit e tyre, nëpërmjet shkresës me Nr. 1683 prot., datë 05.05.2023 i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit për zbatimin e rekomandimit të lënë.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 4899 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit me lëndë: “Kërkesë për ngritjen e grupit paraseleksionues, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të përfituesve të Banësive Sociale me qira në Shkozë, ish fonderia Mek”.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës me Nr. 4898 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, me lëndë: “Për parashtrimin e problematikave faktike dhe administrative të Banësive Sociale Shkozë, ish fonderia Mek”.

Rekomandimi është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për përdorimin e palestrave të shkollave për aktivitetet sportive, mungon marrja e pëlqimit nga drejtorët e shkollave, të cilët nuk kanë firmosur marrëveshjet e lidhura, në kundërshtim me VKB-në nr. 7, datë 31.01.2018. Në kontratat e lidhura nga Bashkia Tiranë, nuk janë përcaktuar qartë të dhënat e ambientit që jepet me qira, duke mos përcaktuar sipërfaqet e tij, kjo për të bërë të mundur saktësimin e vjeljes së tarifës përkatëse në bazë të nenit 73 të Vendimi Nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: DPOP për kontratat e lidhura për palestrat, të qartësojë me Bashkinë Tiranë si organ epror, vlefshmërinë e tyre kur konstatohen parregullsi në mos përputhje me VKB Nr. 7, datë 31.01.2018, që ka të bëjë me marrëveshjen Tip dhe tarifën përkatëse sipas objektit për të cilën janë lidhur këto kontrata. Të gjitha kontratat që do lidhen në vijim, të përcaktojnë saktë edhe sipërfaqet e dhëna me qira, kjo për të përcaktuar vlerën e saktë që duhet të paguajnë përdoruesit e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm Nr. 1489 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 17 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga ana e Bashkisë Tiranë për lidhjen e kontratës 2-palëshe, ndërmjet Federatës Sportive/Shoqatës Sportive/Klubit Sportiv dhe Bashkisë Tiranë për shfrytëzimin e palestrave dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive referuar VKB nr. 7, datë 31.01.2018. Janë marrë masa nga ana e Drejtorisë së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit për marrjen në dorëzim të palestrës me P.V datë 30.11.2023, ku përcaktohet sipërfaqja e ambientit sportiv dhe tarifa përkatëse sipas VKB 158, datë 26.12.2018. Me aktmarrëveshje përkatëse për përdorimin e palestrës të Shkollave “Edit Durham”, “Kosova” dhe “1 Maji”.

Rekomandimi është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për bodrumet dhe vendstrehimet konstatohet se ka mangësi për monitorimin e tyre, që lidhet me mungesën e procesverbalit të gjendjes fizike të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës (shoqëruar dhe me pamje fotografike të momentit), në mospërputhje me germën a) të pikës 2, kreu VI i VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Në kontratat tip të dhënies me qira të vendstrehimeve mungon një përcaktim i plotë dhe posaçëm i të drejtave dhe detyrimeve të palëve në kontratë.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se mungon një data bazë ose një liste e saktë e numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, me qëllim arkëtimin konstant të detyrimeve nga qiraja.

Rezulton të mos ketë publikime të mundësive apo hapësirave ligjore që qytetarët kanë për marrjen me qira të bodrumeve apo vendstrehimeve, me qëllim mirëmbajtjen, vënien në ruajtje si edhe krijimin e të ardhurave për institucionin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 659 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 49-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

9.1. Rekomandimi: Njësia përgjegjëse, në vijim, në lidhjen e kontratave me subjektet përkatëse, të procedojë me hartimin e dokumentacionit shoqërues të këtyre kontratave në funksion të përcaktimit të sipërfaqes dhe rrjedhimisht edhe të vlerës së qerasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.1 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm Nr. 1490 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 18 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Janë marrë masat, për lidhjen e kontratave të qirasë për bodrume dhe vendstrehime referuar VKM-se Nr. 280/1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”.

Rekomandimi është zbatuar

9.2. Rekomandimi: DPOP të krijojë një data bazë të numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, si dhe të mundësohet publikimi i këtyre objekteve me qëllim krijimin e të ardhurave për Bashkinë Tiranë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Shërbimit D.D.D në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1491 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit Nr.19 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka përcjellë shkresën me Nr. 1491/1 prot., datë 08.05.2023 me anë të cilës është vendosur në dispozicion lista e vendstrehimeve dhe bodrumeve së bashku me adresat përkatëse dhe gjendjen e tyre faktike.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për marrjen e magazinave me qira, konstatohet se ka mangësi në procedurën e marrjes me qira, në mospërputhje me nenin 5, 8, 16, si dhe pikën 4 të nenit 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Nga ana e Titullarit të Institucionit nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm që të përcaktojë në mënyrë shteruese të gjithë procedurën e marrjes me qira, me qëllim përdorimin eficient, efektiv dhe me ekonomi të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

-Rezulton të mos ketë publikime të njoftimit për marrjen me qira të ambienteve për magazinë, si dhe nuk është përcaktuar dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin ofertuesit.

-Nga kontrolli i dosjeve nuk dokumentohet kriteri që lidhet me sigurinë, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht: Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisa me sisteme alarmi për zjarret). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPOP dhe personat e ngarkuar sipas urdhrave të miratuar prej tij për lidhjen e kontratave për qiratë e ambienteve, të përcaktojnë në mënyrë shteruese elementët kryesorë që kanë të bëjnë me objektin e qirave, kjo për të rritur eficientësinë e përdorimit të fondeve. Të merren masa në vijim për publikimin e kërkesave për marrje ambientesh me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1492 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.20 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, janë marrë masat për lidhjen e Kontratës së Qirasë me Nr. 4515 Rep dhe Nr. 1446 Kol, datë 29.09.2023 për objektin Magazinë me adresë: “Lalm, Vaqarr”, gjithashtu janë marrë masat për lidhjen e Kontratës së Qirasë Nr.7397 Rep. dhe Nr.4111 Kol, datë 18.10.2023 për objektin magazine me adresë: “Pezë e Vogel”, Tiranë.

Rekomandimi është zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 47 procedurave të prokurimit publike për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 14 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1 Rekomandim:Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurime publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1493 prot., datë 19.04.2023, “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.21 sipas Raportit Përfundimtar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot., datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka evidentuar problematikat lidhur me procedurat e prokurimit dhe ka marrë masa për sistemimin e situatës në vijimësi.

Rekomandimi është në proces

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për blerje mallrash, në 2 raste procedura duhej të ishte ndarë në lote, konkretisht procedurat e vitit 2021 me objekt “Blerje vegla pune” si dhe “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë” pasi mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta, Mos ndarja në lote kufizon pjesëmarrjes e operatorëve ekonomik, pasi një numër i vogël OE mund të kenë objekt të aktivitetit të tyre, të dy objektet e procedurës që prokurohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 29 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me nenin 42 të VKM-në nr. 285/2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për të realizuar këtë ndarje dhe hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1494 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.22 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot., datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka evidentuar problematikat lidhur me procedurat e prokurimit dhe ka marrë masa për sistemimin e situatës në vijimësi.

Rekomandimi është në proces

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin i procedurave të prokurimit për punë publike, është vendosur në shumicën e tyre si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e ligjit. Pra ky kriter rezulton i pa argumentuar dhe i pa lidhur me objektin e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dispozitën ligjore të cituar më sipër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Projekt Raportit të Auditimit).*

13.1 Rekomandim: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të marrë masa për shmangien e kriterëve të pa argumentuara dhe të pa lidhura me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1495 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.23 sipas Raportit Përfundimtar të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot., datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka evidentuar problematikat lidhur me procedurat e prokurimit dhe ka marrë masa për sistemimin e situatës në vijimësi.

Rekomandimi është në proces

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me objekt blerje mjetesh, konkretisht “Blerje automjet P” dhe “Blerje automjet kamionçinë A 5+1/6+1 vende me bagazh hermetik”, rezulton se specifikimet teknike të vendosura janë me diferenca minimaliste apo fikse për parametrat teknik, specifikime të cilat mund të pengojnë konkurrencën, dhe janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Specialistët e fushës në Komisionin për Hartimin e Specifikimeve Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të marrin masa për vendosjen e specifikimeve teknike sa më përfshirëse, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1496 prot. datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr.24 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot., datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka evidentuar problematikat lidhur me procedurat e prokurimit dhe ka marrë masa për sistemimin e situatës në vijimësi.

Rekomandimi është në proces

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 47 procedurave të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2020 – 31.12.2022, u konstatua në 13 raste kualifikim i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbyshjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, dhe nenin 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3, të ndryshuara me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i DPOP, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

15.2 Nga verifikimi rezultoi se, në mbështetje të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1497 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 25 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot. Datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka evidentuar problematikat lidhur me procedurat e prokurimit dhe ka marrë masa për sistemimin e situatës në vijimësi.

Rekomandimi është në proces

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, nuk administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit/infrastrukturore, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1498 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 26 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga ana e Drejtorisë Teknike dhe Transportit me Nr. 1498/1 prot., datë 04.05.2023 me lëndë: “Konfirmim për zbatimin e rekomandimit Nr. 26 sipas Raportit Përfundimtar”, janë marrë marrë masat për të monitoruar praktikar e argumentimeve teknike për procedurat e prokurimit me onjekt mirëmbajtjet e thella në objektet shkollore që mirëmban drejtoria jonë. Në të gjitha rastet kur preventive i punimeve përfshin zëra punimesh që e kërkojnë këtë leje do të aplikohet për miratimin e saj pranë strukturave përgjegjëse në Bashkinë Tiranë.

Rekomandimi është në proces

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se objekti i rikonstruktuar “Ish Garda, edhe pse është kolauduar në datën 28.12.2021, nuk është vënë në shfrytëzim nga Investitori. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të merren masa të menjëhershme për iniciimin e shfrytëzimit të këtij objekti, me qëllim ruajtjen dhe administrimin sa më të mirë të tij.

Menjëherë

17.2 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për ngritjen e Urdhërit të Brendshëm Nr. 1499 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 27 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Përsa i përket objektit të ish-Gardës së Republikës së Shqipërisë, referuar VKB-së Nr. 177, datë 25.03.2021 dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 13390/2, datë 02.04.2021,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

si dhe shkresës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike me Nr. 1241 prot., datë 08.04.2021 pasqyrohet situata lidhur me këtë objekt marrjen e masave nga ana jonë për përshatjen e objektit për punonjësit e Policisë Bashkiake dhe të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit. Ky objekt referuar VKB-së Nr.142, datë 23.12.2022, i ndryshuar, ky objekt është kthyer Muze i Trashëgimisë Kulturore referuar dhe korrespondencës shkresore ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Promovimit të Qytetit Bashkia Tiranë.

Rekomandimi është zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se grupi i pompave të furnizimit me ujë nuk ekzistonte. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për mungesën e këtij zëri pune dhe të përcaktohet personi përgjegjës që do të zëvendësojë grupin e pompave ose të dëmshpërblejë vlerën e dëmit ekonomik.

Menjëherë

18.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1500 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 28 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkresës së përcjellë nga Sektori Juridik dhe Prokurimeve në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me Nr. 1673/3 prot., datë 09.06.2023, Sektori Juridik dhe Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike Burimeve Njerëzore dhe Performancës ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi, duke përcaktuar personin përgjegjës për zëvendësimin e grupit të pompave ose dëmshpërblimin e dëmit ekonomik.

Drejtoria Teknike dhe Transportit ka përcjellë shkresën me Nr. 1500/1 prot., datë 13.06.2023 me lëndë: “Njoftim për zëvendësimin e grupit të pompimit në objektin e ish-Gardës sipas kontratës me Nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020 “Mirëmbajtje e thellë e objekteve Publike”.

Rekomandimi është zbatuar

Masa për shpërblim dëmi.

KLSH i ka rekomanduar DPOP, 1 masë shpërblim dëmi, në vlerën **232,320 lekë**, që është pranuar.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat e KLSH”, shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 232,320 lekë** si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike*”, *Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 38,197,800 lekë, fituar nga OE R, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 232,320 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë dhe OE R. (*trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandim: Nga DPOP, Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **232,320 lekë pa tvsh** nga OE R, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 49/5 prot., datë 21.12.2020, me objekt “*Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike*”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr.1501 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 29 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Drejtorisë Ekonomike janë marrë masat lidhur me arkëtimin e vlerës 278.784 Lekë me TVSH nga ana Operatorit Ekonomik R në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Tiranë sipas Urdhër Shpenzimit Nr.328 datë, 14.07.2023.

Rekomandimi është zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

KLSH i ka rekomanduar DPOP, 2masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën **134,744,012 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për dhënie me qira të banesave sociale, rezulton debi e akumuluar në vlerën 100,589,491 lekë, nga të cilat,

- *Për vitin 2017 janë 297 debitorë me vlerën e detyrimit 19,306,264 lekë;*
- *Për vitin 2018 janë 330 debitorë me shumë e debisë prej 36,275,766 lekë;*
- *Për vitin 2019 janë 331 debitorë me vlerën e detyrimit prej 57,472,830 lekë;*
- *Për vitin 2020 janë 338 debitorë me vlerën e detyrimit në 28,445,386 lekë;*
- *Për vitin 2021 janë 305 debitorë në vlerë të detyrimit prej 22,144,145 lekë;*

-Rezultoni se është krijuar debi ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë.

-Nga ana e saj Drejtoria e Strehimit ka raportuar në Bashkinë Tiranë, por mbajtja e statusit “raportim” jo vetëm që nuk ka sjellë marrjen e masave për zgjidhjen e problemit, por ka rezultuar me rritjen e numrit të debitorëve dhe të vlerës së detyrimit. Ky detyrim i përket kontratave me tarifa të pa përditësuara, të cilat janë modeste dhe të përballueshme nga përfituesit. Mungesa e bashkëpunimit mes DPOP Tiranë me Drejtorinë e Strehimit Social/Bashkia Tiranë, është arsyeja bazë e krijimit dhe thellimit të problematikes nga viti në vit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 44-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1 Rekomandim: Nga DPOP, Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj-Drejtoria e Banësive Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të qerasë dhe të marrin masa për hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore, me qëllim arkëtimin e vlerave të debitorëve në shumën 100,589,491 lekë, dhe pagesën e vlerave të detyrimit ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

Menjëherë

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1502 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 30 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, janë marrë marrë masat për njoftimin e debitorëve për pagimime detyrimeve të prapambetura në Banesat Sociale në Shkozë, referuar Urdhërit të Brendshëm Nr. 4846 prot., datë 11.12.2023 “Për marrjen e masave për njoftimin e debitorëve, pagimin e detyrimeve të prapambetura në Banesat Sociale në Shkozë”.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 4899 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit me lëndë: “Kërkesë për ngritjen e grupit paraseleksionues, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të përfituesve të Banesave Sociale me qiranë në Shkozë, ish fonderia Mek”.

Gjithashtu, nëpërmjet shkresës me Nr. 4898 prot., datë 13.12.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, me lëndë: “Për parashtrimin e problematikave faktike dhe administrative të Banesave Sociale Shkozë, ish fonderia Mek”.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për dhënie të palestrave me qira ndërmjet DPOP si Drejtori Mbikëqyrëse dhe subjekteve përfituese, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet në vlerën 1,526,525 lekë, nga të cilat për vitin 2018 janë 15 debitorë me shumën e detyrimit 232,130 lekë; për vitin 2019 janë 9 debitorë me shumën e detyrimit 59,475 lekë nga të cilët 3 debitorë janë të trashëguar nga viti 2018 në shumën e 29,475 lekë; për vitin 2020 janë 50 debitorë me shumën e detyrimit 1,012,025 lekë; për vitin 2021 janë 38 debitorë me shumën e detyrimit 514,500 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 47-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Nga DPOP Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj-Drejtoria e Aseteve e Koordinimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të tarifës për palestrat shkollore të dhëna në përdorim dhe të marrin masa në hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore me qëllim përmirësimin e situatës për të arkëtuar vlerën e plotë të detyrimit prej 1,526,525 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

Menjëherë

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1503 prot., datë 19.04.2023 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Rekomandimit Nr. 31 sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës me anë të shkresës Nr. 1503/1 prot., datë 03.05.2023 i është drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit me anë të cilës kërkohet informacion mbi zbatimin por nuk ka përgjigje dhe masa të marra.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar DPOP, 7 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” shkronjat “e” dhe “ç”, të nenit 1, Kreu IV dhe nenet 37 dhe 44 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Masat disiplinore të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

z. K.LL., me detyrë *Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 12 (dymbëdhjetë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. A.U., me detyrë *Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Transportit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 7 (shtatë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. E.LL., me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Godinave Arsimore dhe Publike*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. E.B., me detyrë *Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Performancës*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. T.D., me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Impianteve dhe Riparimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. A.S., me detyrë *Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 3 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

z. K.L., me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Koordinimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për dhënie masa disiplinore referuar:

1. Urdhëri i Brendshëm me Nr. 1505 prot., datë 19.04.2023, për K.LL është marrë masë disiplinore;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

2. Urdhëri i Brendshëm me Nr. 1509 prot., datë 19.04.2023 për A.U është marrë masë disiplinore;
3. Urdhëri i Brendshëm me Nr. 1506 prot., datë 19.04.2023 për E.B është marrë masë disiplinore;
4. Urdhëri i Brendshëm me Nr. 1507 prot., datë 19.04.2023 për T.D është marrë masë disiplinore;
5. Urdhëri i Brendshëm me Nr. 1508 prot., datë 19.04.2023 për A.S është marrë masë disiplinore;
6. Urdhëri i Brendshëm me nr. 3473/1, datë 14.09.2023, është miratuar zgjidhja e kontratës për punonjës in E.LL;
7. Sipas relacionit nr. 1486 prot, datë 18.04.2023, është propozuar që për punonjës in K.L mos ti jepet masë disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

Përmbledhëse e Masave

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pjesërisht (Pa procedura) filluar	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	28	28	18	1						9				
III	MASA SHPËRBLIM DËMI	1	1	1		1	232	1	232	1	232				
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV	MASA DISIPLINORE	7	7	7											
	(Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil														
V	MASA 3E	2	2		2	2	134,744	2	134,744					2	134,744
	Nga të cilat:														
	Të ardhura të munguara	2	2		2	2	134,744	2	134,744					2	134,744
VI	Dhe të tjera masa nëse ka Gjyba APP														

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në DPOP, Bashkia Tiranë për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 1007/8 prot., datë 28.03.2023, rezulton se subjekti i audituar **ka respektuar** afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, por **nuk ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve lenë me shkresën nr. 1007/8, datë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë”

28.03.2023 që rezultojnë të pa zbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandim nr. 4.3 Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës të plotësojë në pasqyrat financiare llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në shumën 100,689,492 lekë.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Rekomandim nr. 1.1: Nga DPOP, Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj-Drejtoria e Banesave Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të qerasë dhe të marrin masa për hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore, me qëllim arkëtimin e vlerave të debitorëve në shumën 100,589,491 lekë, dhe pagesën e vlerave të detyrimit ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

Në vijimësi

2. Rekomandimi nr. 2.1: Nga DPOP Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj-Drejtoria e Aseteve e Koordinimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të tarifës për palestrat shkollore të dhëna në përdorim dhe të marrin masa në hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore me qëllim përmirësimin e situatës për të arkëtuar vlerën e plotë të detyrimit prej 1,526,525 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

Në vijimësi

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT E KLSH-së

R.K (Përgjegjës grupi)

E.K

F.Ç

M.M

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K.Gj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2023 DERI 30.06.2022, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, BASHKIA TIRANË”**

Tiranë 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit	5
I/4. Metodologjia e Auditimit	5
I/5. Konkluzioni	6
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, BASHKIA TIRANË	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	35



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në 6 subjekte, respektivisht: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Njësia Administrative Dajt, Njësia Administrative Petrelë, Njësia Administrative Farkë dhe Njësia Administrative Zall-Herr (Bashkia Tiranë): “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, kemi këtë situatë:

DPPGJ, ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve në KLSH me shkresën nr. 1008/11, datë 30.06.2023.

- Nga 26 masa organizative të pranuar nga subjekti, janë zbatuar 20 rekomandime, 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe 5 rekomandime janë në proces.
- Nga 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale prej 4,172,200 lekë të pranuar nga subjekti, është zbatuar 1 rekomandim dhe 1 rekomandim është në proces.
- Nga 10 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet, në vlerën totale 43,664,920 lekë të pranuar nga subjekti, janë zbatuar 5 rekomandime dhe 5 rekomandime janë në proces.
- Nga 31 masa disiplinore të pranuar, janë zbatuar plotësisht.

I/1. Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 191/7 prot., datë 20.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 25.03.2024, u krye auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R.K- Përgjegjës grupi
2. E.K - Anëtare
3. F.Ç - Anëtar
4. M.M - Anëtar

Cështjet e Audituar:



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

1. Hartimi i programit (*Plan veprimit*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.
6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në DPPGj me shkresën nr. 1008/10, datë 02.06.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se nga DPPGj kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e 26 masave organizative, 2 masa për shpërblim dëmi, 10 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike dhe 31 masa disiplinore të lëna, të cilat janë pranuar nga DPPGj.

Masa organizative

Nga 26 masa organizative, janë zbatuar 20 rekomandime, 5 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Masa për shpërblim dëmi

Nga 2 Masa për shpërblim dëmi, është zbatuar 1 masë dhe 1 tjetër është në proces.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike.

Nga 10 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet, janë zbatuar 5 rekomandime dhe 5 rekomandime janë në proces.

Masa disiplinore

Nga 31 masa disiplinore, janë zbatuar plotësisht.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, BASHKIA TIRANË

1. Auditimi i fundit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë

Auditimi i fundit në DPPGj është kryer në vitin 2023 për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 1008/10 prot., datë 02.06.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 26 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 2 masa shpërblim dëmi, në vlerën 4,172,200 lekë, pranuar nga subjekti;
- 10 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet, në vlerën 43,664,920 lekë, pranuar nga subjekti;



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

- 31 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, DPPGj duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, DPPGj për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 1008/10 prot., datë 02.06.2023 ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1008/11, datë 30.06.2023 ku pasqyrohen veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe strukturat përgjegjëse.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 1008/10 prot., datë 02.06.2023, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Sipas verifikimit DPPGj ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1008/13, datë 19.01.2024.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se DPPGj ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1008/10 prot., datë 02.06.2023, por nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në DPPGj

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar DPPGj 26 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit” (këtu e më poshtë DPPGJ) është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2021.

KLSH ka dërguar në DPN1 e Qytetit Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 878/8 prot., datë 20.12.2017, protokolluar në DPN1 të Qytetit Tiranë (ndryshuar emri i institucionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

në DPPGJ) me shkresën nr. 2129/6 prot, datë 23.12.2017, ndërsa nga DPN1 e Qytetit Tiranë për zbatimin e rekomandimeve është kthyer përgjigje me shkresën nr. 878/9, datë 23.01.2018, në të cilën janë 21 masa organizative, 2 masa për shpërblim dëmi, 1 masë për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit, dhe 9 masa disiplinore, të cilat janë pranuar nga DPN1 e qytetit Tiranë. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 2623/3 prot., datë 24.12.2018 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 e punëtorëve të qytetit Tiranë”, për veprimtarinë e DPN1 e qytetit Tiranë nga data 15.07.2015 deri më 30.06.2017, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

-Nga rikërkimi i zbatimit të rekomandimeve masa organizative të mbetura në proces është konstatuar se është 1(një) rekomandim në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: DPPGJ të analizojë me përgjegjësi moszbatimin e rekomandimeve, duke marrë masat e menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1188/6, datë 07.08.2019.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, nga ish titullari nuk evidentohet të jenë marrë masa për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive për mos zbatimin e rekomandimeve nga auditimi para ardhës. Ndërkohë që janë marrë masa për zgjidhjen e situatës së vlerës debitore 15 vjeçare për të cilën është konkluduar se si pasojë e kalimit të afatit të parashkrimit, nuk është e mundur të ngrihen padi. Për këtë qëllim, DPPGJ i është drejtuar Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 1150, datë 12.06.2023, për mendim për zgjidhjen e situatës.

Rekomandimi është në proces

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” u konstatua debitimi i shumës prej 4,724,015 lekë, e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në Pasqyrat Financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”. Shuma prej 4,724,015 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” duke kërkuar financim të pritshëm nga shteti me tepër për këtë shumë, vlerë e cila është e paidentifikuar dhe s’ka të bëjë me shpenzime të konstatuar të vitit ushtrimor.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit së DPPGJ-së të marrë masa për sistemimin e shumës 4,724,015 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGj ka kryer sistemimin sipas rekomandimit, por veprimi është kthyer mbrapsht nga Drejtoria e Monitorimit Financiar me arsyetimin se në këtë llogari pasqyrohen veprime që janë rakorduar me thesarin dhe Dega e Thesarit nuk ka pranuar të rakordojë për këtë veprim i cili nuk është krujuar vitin e fundit dhe nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues.

Rekomandimi është zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nga të dhënat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar të Institucionit më 31.12.2021, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet si vijon:

2.1.Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 20,496,402 lekë, të cilat vijnë kryesisht nga debitorë të krijuar për një periudhë shumë të gjatë rreth 15 vjet. Për këto debitorë, institucioni i DPPGJ-së nuk ka mundësi arkëtimi. E njëjta shumë debitorësh është konstatuar dhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

2.2.Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim material në rezultatin e pasqyrave financiare. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” janë keqklasifikuar “Pajisjet dhe instalimi i kondicionerëve” në shumën 621,600 lekë. Kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.

Llogaria 213 “Rruga, rrjete, vepra ujore” paraqitet në pasqyrat financiare me kosto historike. Vlera e amortizimit të akumuluar nuk është përlllogaritur ndër vite, gjë e cila është trashëguar dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021.

2.3.Nga lëvizjet e aktiveve nga sistemimet, institucioni bën lëvizjen e asetëve nga llogaria përkatëse 21 “Aktive afatgjata” në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në shumën 55,964,019 lekë përfaqëson të gjitha aktivet e dëmtuara që DPPGJ ka identifikuar të dëmtuara nga komisionet e inventarizimit. Shuma prej 55,964,019 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 24, pasi secili nga aktivet e dëmtuara duhet të klasifikohet në llogarinë përkatëse të aktiveve, deri në momentin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 3-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve të marrin masa për pjesën e llogarive debitorë që kalojnë kohën e parashkrimit



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

me qëllim sistemimin e këtyre shumave të cilat qëndrojnë në llogaritë e DPPGJ-së për periudha mbi 15 vjeçare.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se për këta debitorë të krijuar ndër vite, DPPGj i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me shkresën nr. 1149, datë 12.06.2023 me qëllim identifikimin e informacionit sipas listës emërore të debitorëve për të vijuar marrjen e masave.

Rekomandimi është në proces

3.2. Rekomandimi: - Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se referuar Urdhrit nr. 185/80, datë 12.06.2023, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPPGj ka kryer sistemimin në ditarët e kontabilitetit dhe do të pasqyrohet ndryshimi me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.

Rekomandimi është zbatuar

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive Afatgjata të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, vetëm ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se janë marrë masa për përlllogaritjen e amortizimit dhe vlerës së mbetur të aktiveve për secilin produkt në pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe kalimin e aktiveve të dëmtuara në llogarinë 24, me vlerën e mbetur të tyre. Për llogaritë është bërë ngritja e grupit të vlerësimit me Urdhër nr. 2489, datë 30.12.2022 për vlerësimin e gjendjes së llog. 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumenta dhe vegla pune në magazinë e rikuperos” dhe Urdhër nr. 2488, datë 30.12.2022 për vlerësimin e aktiveve në llog. 211 “Pyje, kullota, plantacione”. Janë mbajtur procesverbalet për vlerësimin e aktiveve të dëmtuara nga komisionet me nr. 2489/1, datë 30.12.2022 dhe nr. 2488/1, datë 30.12.2022.

Rekomandimi është zbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

-vendime të formës së prerë marrë në vitin 2014 në shumën 913,566 lekë, në vitin 2016 në shumën 268,229 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 3,702,911, të cilat janë likuiduar në vitin 2018;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, dhe në vitin 2018 në shumën 7,639,947 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2019;

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 405,769 lekë, në vitin 2018 në shumën 1,537,134 lekë, dhe në vitin 2019 në shumën 4,526,208 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2020;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

- vendime të formës së prerë marrë në vitin 2018 në shumën 677,142 lekë, në vitin 2019 në shumën 637,609 lekë, dhe në vitin 2020 në shumën 1,591,305 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2021, nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

Si pasojë llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Konkretisht për vitit 2018-2021, ky zë për vendimet gjyqësore reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.

Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

Duke ju referuar pagesave të kryera nga DPPGJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë e në vijimësi

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, gjatë vitit 2023, janë planifikuar për tu likuiduar 2 vendime gjyqësore sipas miratimit të buxhetit për të cilat është respektuar radha e likuidimit sipas parimit FIFO.*

Rekomandimi është zbatuar

4.2.Rekomandimi:Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve koordinohet periodikisht me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin rast pas rasti të detyrimeve që lindin për proceset gjyqësore.*

Rekomandimi është zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të DPPGJ-së, u konstatua se institucioni ka një regjister elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe 30.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 4-5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës ka hartuar regjistrin e aseteve me të dhënat për secilin prej tyre, data e blerjes, çmimi, sasia etj.

Rekomandimi është zbatuar

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se titullari i institucionit të DPPGJ-së nuk ka ngritur asnjë komision për vlerësimin e aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit janë evidentuar aktive të dëmtuara për llogarinë ekonomike 214 “Stola, Kosha, Gjeneratorë etj.”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 96.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Titullari i institucionit të DPPGJ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga komisioni i inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, titullari i DPPGJ ka ngritur Urdhrin nr. 1801 datë 11.09.2023, “Për ngritjen e komisionit për magazinën rikupero”, Urdhrin nr. 1801/1 datë 11.09.2023, “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin hyrje dhe dalje në magazinën qendrore” dhe Urdhrin nr. 1909/1 datë 25.09.2023, “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e të gjithë bimësisë ekzistuese dhe mbjelljet e reja për vitin 2023”. Gjithashtu me shkresën nr. 185/102 datë 21.12.2023, është kërkuar të vihen në dispozicion relacionet për periudhën 2018-2021

Rekomandimi është zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të Aktiveve Afatgjata Materiale u konstatua se: Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitet 2018-2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlerën zero lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit, me pretendimin se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i aseteve të institucionit të DPPGJ menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Aseteve dhe Licencimit pranë Bashkisë Tiranë. Për secilin truall



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës, duke u referuar në çmimin për m² sipas zonave kadastrale, sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Sipërfaqja totale e tokës që DPPGJ ka në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, paragrafi 62, dhe paragrafi 91.

Për periudhën 2018-2021, komisionet e inventarizimit kanë evidentuar ndërtesa të cilat nuk ekzistojnë, por që vazhdojnë të jenë të regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”. Në vitin 2019, për secilin objekt, komisioni i inventarizimit ka paraqitur, me anë të shkresës nr. 2985/1 Prot., datë 24.01.2020, procesverbalet e mbajtura për verifikimin në terren, ku në procesverbalin e mbajtur në terren, datë 13.01.2020, Komisioni i inventarizimit konstaton se 3 objektet: (1) “Barakat” (me vlerë kontabël 5,409 lekë, viti 1981), (2) “Zyrat e kuartallave nr. 4” (me vlerë kontabël 45,000 lekë, midis Rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës) dhe (3) “Ofiçina tek Vasil Shanto” (me vlerë kontabël 25,811 lekë, viti 1980), nuk ekzistojnë pasi janë bërë pallate.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit shprehet se nuk ka në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me mungesën e aktiveve. Për vitin 2021, komisioni i inventarizimit konstaton një diferencë prej 5,584,596 lekë mes gjendjes fizike dhe të dhënave të regjistruara në kontabilitet, pasqyruar kjo në inventarin përmbledhës për inventarizimin e asetëve të DPPGJ-së për vitin 2021 me nr. 2948/2 Prot., datë 22.01.2022, ku shprehet se 15 prej objekteve pjesë e inventarit nuk ekzistojnë fizikisht. Përpos konstatimeve të komisionit të inventarizimit, nga ana e DPPGJ-së nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ndërtesave, me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin ndërtesave që DPPGJ ka nën administrim.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 95, 101, 118.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me ekspertë të fushës me qëllim identifikimin e planimetricave dhe gjendjes së sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGJ i është drejtuar Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 1147 datë 12.06.2023 “Për informacion mbi 15 asetet që nuk ekzistojnë” dhe me shkresë nr. 1148 datë 12.06.2023 “Kërkesë për ngritjen e grupit të punës me ekspert të fushës nga Bashkia Tiranë për këto 15 asetet”. Në përgjigje të sa më lartë bashkia Tiranë ka kërkuar informacion hartografik shtesë për identifikimin e asetëve në funksion të përbushjes së rekomandimit.

Rekomandimi është në proces

7.2. Rekomandimi: DPPGJ në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrin masa për të ngritur një grup pune me qëllim identifikimin dhe rivlerësimin e stokut të ndërtesave gjendje nën administrimin e DPPGJ-së. Pas vlerësimit të dalë nga komisionet, të merren masa të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për regjistrimin e aktiveve të pa pasqyruara në kontabilitet, si dhe pasqyrimin e tyre në vlera reale referuar tregut.

Menjëherë e në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGj i është drejtuar Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 1791, datë 12.12.09.2022 për të cilën ka marrë përgjigje me shkresën nr. 33973/2, datë 12.10.2022 se referuar Vendimit Nr. 31, datë 05.04.2017 për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pasurive sheshe, tregje, poliklinika, të ndërmarrjes funerale dhe të drejtorive të përgjithshme nr. 1, 2 dhe 3 të punëtorëve të qytetit, që janë nën juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë tiranë dhe kërkesës për transferimin përfundimtar nga këshilli i ministrave”, Bashkia ka kërkuar pranë ASHK vijimin dhe përfundimin e procedurës për transferimin dhe është në pritje të mbylljes së procesit. Gjithashtu DPPGj i është drejtuar me shkresë Bashkisë Tiranë për vënien në dispozicion të informacion të detajuar në lidhje me statusin e pronave sipas listës që drejtoria disponon në Pasqyrat Financiare, përkatësisht me shkresën nr. 1807 prot, me dt. 22/09/2022 dhe shkresën nr. 62 prot. dt 10/01/2023 për llogarinë 212 ku pas pajisjes me dokumentat përkatëse të pronave do të vijohen procedurat e më tejshme.

Rekomandimi është në proces

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurën e prokurimit “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, të vitit 2020, rezulton se:

Në përlllogaritjen e fondit limit në total është llogaritur për 15 trajtime (dezinfektim), ndërkohë që në DST është specifikuar që shërbimi do të kryhet çdo 24 orë për një afat 1 mujor nga data e lidhjes se kontratës me intervale të rregullta ditore sipas shtojcës 10 “Shërbimet dhe Grafikut të Ekzekutimit”, pra në hartimin e DST nuk është caktuar saktë grafiku i trajtimit (dezinfektimit). Këto veprime në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit, Shtojca 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në çdo rast në përlllogaritjen e fondit limit, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë saktësisht vlerën sipas kritereve të vendosura në DST.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi me zgjedhje për hartimin e DST rezultoi se, në proces verbalin nr. 379/1 Prot. datë 25.02.2022 “Mbi hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin Teknik të kontratës me objekt: Shërbimi i sigurimit të mjeteve të transportit për nevoja të DPPGJ”, evidentohet argumentimi i kritereve.

Rekomandimi është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, të vitit 2020, rezulton se, janë hartuar 2 situacione të nënshkruara nga mbikëqyrësit e kontratës dhe OE të cilat janë pjesë e dokumentacionit ku dhe është përcaktuar njësia, sasia, çmimi dhe numri i trajtimeve, por rezulton që këto situacione nuk kanë datë, dhe në asnjë rast nuk është vërtetuar që shërbimi është kryer sipas kontratës nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.”, neni 7, ku kërkohet që ky shërbim të jetë kryer çdo 24 orë, me pompë dhe nga punonjës të pajisur me të gjithë mjetet e sigurisë në punë (kostume një-përdorimshe,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

dorashka, maska, syze transparente), veprime në kundërshtim me Kontratën nr. 1160/10, datë 26.03.2020 për “Dezinfektimi i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, neni 7. (Më hollësisht trajtuar në faqet 99-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e saktë të dokumentacionit justifikues për kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës nga ana e kontraktorit.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e DPPGJ janë marrë masa për plotësimin e dokumentacionit përkatës justifikues por nuk rezultoi të jenë nxjerrë përgjegjësit për mangësitë e konstatuara.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre”, të vitit 2020, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht veprimet bankare, u konstatua se, fatura origjinale e OE mbart datën 30.06.2020 dhe është paguar me dy Urdhër Shpenzime në datë 21.10.2020 dhe 11.12.2020, pra ka kaluar afati i pagesës së faturës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, ku citohet, germa “c”, Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”, ku citohet se “stok i detyrimeve të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, dhe Kontratën nr. 1057/11, datë 30.03.2020, nenin 6 “Kushtet e pagesës”, pika 2 ku citohet “Pagesa si rregull do të bëhet, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që është dorëzuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës nga kontraktuesi”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 106-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: DPPGJ, Bashkia Tiranë të marrë masa që hartimi i programeve buxhetore afatmesëm të jenë sa më të drejtë e në përputhje me kërkesat e institucionit duke shmangur kështu shpenzime pa efektivitet të penalteteve që mund të akumulohen nga vonesat në likuidimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment: Nga verifikimi të hartimit të buxhetit dhe korrespondencës me Bashkinë Tiranë rezultoi se, DPPGJ, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masat e nevojshme duke bërë kërkesat e PBA-së në bazë të nevojave të çdo drejtorie gjithashtu ka marrë masa duke kërkuar nga Bashkia Tiranë vënien në dispozicion të fondeve për të likuiduar pagesat në kohë duke kërkuar çelje të fondeve edhe përtej limiteve të vendosura nga Bashkia Tiranës në rastet kur shuma e faturave tejkalon limitin e vendosur prej saj.

Rekomandimi është zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit rezultoi se, gjatë hartimit të Dokumenteve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Tenderit u konstatuan parregullsi në argumentimin e kriterëve për kualifikim, të cilat kanë kufizuar konkurrencën, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në procedurën: “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”
- Në procedurën: “Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës (kosha, stola dekorativ)”
- Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”
- Në procedurën: “Rikualifikim i mikro hapësirave të gjelbërta”
- Në procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikro hapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi
- Në procedurën: “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”
- Në procedurën: “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”

(Më hollësisht trajtuar në faqet 114-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të marrë masa për përcaktimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në natyrën e kontratës, si dhe për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit duke argumentuar dhe dokumentuar në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi me zgjedhje i procedurës me objekt shërbime agroteknike për vitin 2023 rezultoi se, referuar procesverbalit të mbajtur nr. 882/1 Prot. datë 16.05.2023 “Mbi hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin Teknik të kontratës me objekt: Shërbime agroteknike (fitopatologjike dhe entomologjike) për nevojat e DPPGJ për vitin 2023”, është përcaktuar saktë lloji i procedurës sipas natyrës së kontratës.

Rekomandimi është zbatuar

11.2.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të administrohet dokumentacioni i nevojshëm identifikues grafik (si plane, harta, etj.) në mënyrë që të mundësohet evidentimi i vendndodhjes së realizimit të punimeve, që ndër të tjera do të shërbejë si gjurmë auditimi.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi me zgjedhje i procedurës me objekt shërbime agroteknike për vitin 2023 rezultoi se, referuar procesverbalit të mbajtur nr. 882/1 Prot. datë 16.05.2023 “Mbi hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin Teknik të kontratës me objekt: Shërbime agroteknike (fitopatologjike dhe entomologjike) për nevojat e DPPGJ për vitin 2023”, është përcaktuar saktë lloji i procedurës sipas natyrës së kontratës.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në SPE i 7 (shtatë) procedurave të prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit në 5 procedura u konstatuan pasaktësi në kualifikim e OE të cilat nuk plotësonin të gjitha kriteret për kualifikim në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në procedurën “Drurë, shkurre dekorative”,
- Në procedurën “Rikualifikim i mikro hapësirave të gjelbërta”,
- Në procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikro hapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi”,
- Në procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”,
- Në procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”,

(Më hollësisht trajtuar në faqet 134-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, me anë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra, shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi me zgjedhje rezultoi se, me proces verbalin datë 16.10.2023 “Procesverbal rivlerësimi bazuar në vendimin e APP nr.64 datë 10.10.2023”, është përmbushur rekomandimi.

Rekomandimi është zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të 7 (shtatë) kontratave u konstatua se për 5 kontrata mungon dokumentacioni kryesorë teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, si libri i masave dhe vizatimeve, ditarët e punimeve, provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve etj. dokumentacioni teknik sipas Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, dhe për 2 kontratat e tjera mungojnë certifikatat e cilësisë së materialeve. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 127-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për ngritjen e një njësie për monitorimin e zbatimit të kontratave, e cila do të jetë përgjegjëse edhe për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik për secilën kontratë, me qëllim verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve, si dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura dhe dokumentacioni i nevojshëm grafik.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGJ ka marrë masa sipas shkresës Nr.47255/1 prot ,datë 25.11.2021 “Urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës së DPPGJ” ku është miratuar krijimi i një drejtorie të re “Drejtoria e Projekteve”, e cila ka në funksionin e saj monitorimin e zbatimit të kontratave .

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën: “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikro hapësirave të gjelbra me shatërvanë në blloqe banimi” rezulton mungesa e lejes për hapjen e puseve. Ku sipas akteve ligjore në fuqi duhet që personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogjeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 159-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për pajisjen me leje për hapje pusi për puset e hapura dhe ato që do të hapen në vazhdimësi sipas përcaktimeve ligjore për menaxhimin e burimeve ujore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, Me anë të Memos Nr.185/97 prot, datë 14.08.2023 është kërkuar informacion mbi disponibilitetin e fondeve buxhetore në kuadër të zbatimit të rekomandimit e sipërcituar.

Rekomandimi është në proces

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave rezultoi se në 3 kontrata, përkatësisht kontratën me nr.1326/14, datë 30.05.2018, kontratën me nr.539/10, datë 10.04.2018 dhe kontratën me nr.99/3, datë 18.01.2021, janë kryer pagesat me urdhër shpenzime pas afatit 30 ditë si specifikohet në KPK neni Afatet e Pagesës, ku citohet “...Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer shërbimet ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë...”. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 127-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi të hartimit të buxhetit dhe korrespondencës me Bashkinë Tiranë rezulton se, DPPGJ, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masat e nevojshme duke bërë kërkesat e PBA-së në bazë të nevojave të çdo drejtorie gjithashtu ka marrë masa duke kërkuar nga Bashkia Tiranë vënien në dispozicion të fondeve për të likuiduar pagesat në kohë duke kërkuar çelje të fondeve edhe përtej limiteve të vendosura nga Bashkia Tiranës në rastet kur shuma e faturave tejkalon limitin e vendosur prej saj.

Rekomandimi është zbatuar

16.Gjetje nga auditimi: Grupi për përllogaritjen e Fondit Limit, ka marrë oferta nga subjektet e A, G dhe I për mallrat e kërkuar pa patur specifikime teknike për këto mallra. Si pasoj subjektet e sipërcituara kanë dhënë oferta fiktive pasi ofertat e tyre nuk bazohen në karakteristika dhe specifikime teknike për mallrat e kërkuara nga AK DPPGJ, Bashkia Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Grupi i auditimit të KLSH, bëri verifikim e statusit të subjekteve të sipërcituar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga rezultoi se, subjekti “A”, nuk ekziston i regjistruar me këtë NIPT. (Më hollësisht trajtuar në faqet 58-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnime në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, me anë të shkresës Nr. 185/92 datë 26.07.2023 DPPGJ-ja i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit Bashkia Tiranë.

Po kështu është mbajtur korrespondencë elektronike nga Titullari i DPPGJ me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në lidhje me trajnimet për punonjësit e DPPGJ-së dhe janë planifikuar trajnime në fushën prokurimit me temë “Prokurim Publik”, niveli bazë në të cilin janë trajnuar punonjësit, A.K me pozicion Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve, A.P me pozicion specialiste në sektorin e Prokurimeve, E.P në pozicionin Drejtor pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, L.L me detyrë përgjegjëse sektori në Sektorin e planifikimit në Drejtorinë e Projekteve si dhe L.H në pozicionin Specialiste në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.

Si dhe në trajnimin me temë “Detyra e sekretarisë dhe të arkivës” ku është trajnuar punonjësjja E.XH me pozicion Specialist I/Arshiv pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Rekomandimi është zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar specifikime vetëm për Autobot 10,000 litra me dy akse dhe Ekskavatorin me rrota.

Specifikimeve e hartuara nga grupi i punës nuk pasqyrojnë kërkesat e paraqitura në shkresën nr. 433 Prot., datë 13.02.2018 të Drejtorit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Shërbimeve të miratuara nga Titullari i AK, pasi në relacionin e datës 13.02.2018 të grupit për hartimin e specifikimeve teknike, nuk janë hartuar specifikimet teknike për Autobotin me kapacitet 12,000 litra.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nuk kanë përputhje me specifikimet teknike të pasqyruara në shtrojsën nr.10 të DST, kryesisht për Ekskavatorin me dy rrota.

Në DST pasqyrohen specifikime teknike për Auto botin 12,000 litra me dy akse ndërkohë që grupi për përcaktimin e specifikimeve teknike në relacion e vete nuk i ka pasqyruar.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike ka shkelur rregullat e LPP pasi në specifikimit teknike të ekskavatorit ka kërkuar që ky mjete të këtë për numër të shasisë Y. (nr. shasisë është unik).

- NJHDT për blerjen e ekskavatori ka vendosur si kriter në DST, që ai të këtë numrin e shasisë Y. Anëtarët e njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit kanë vepruar në mospërputhje me Ligji 9643 për prokurimet publike, i ndryshuar. Neni 23-Specifikimet teknike pika 5, ku parashikohet se:

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1.Rekomandimi: Titullari i AK t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të DST nga grupet e punës/njësia e prokurimit.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi me zgjedhje rezultoi se, është përmirësuar procesi i hartimit të DST.

Rekomandimi është zbatuar

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, komisioni i marrjes në dorëzim dhe koaludimit, në process verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të eskavatorit me rrota, në faqen 2 të PV, mjetin ekskavator me rrota e kanë identifikuar nëpërmjet nr. të motorit Y.

Nga auditimi rezulton se, ky model është i njëjtë me specifikimet e përcaktuara nga komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, të cilat pas ankimimit të bërë nga 3 OE u hoqën nga DST.

Por komisioni i marrjes në dorëzim ka vazhduar që në proces verbalin e hartuar gjatë procesit të marrjes në dorëzim të pasqyroj tipin e motorit të ekskavatorit me modelin fillestar që AK paraqiti fillimisht në specifikimet teknike dhe të pasqyruara në DST, para se ato të ndryshoheshin me shtojcën nr. 433/6 Prot. date 26.02.2018.

-Gjithashtu PV i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është shoqëruar me foto të mjeteve të transportit të marra në dorëzim dhe në PV nuk ka referuar dokumentin e zhdoganimit të mjeteve dhe duke mos pasqyruar markën dhe tipin e mjeteve të transportit të marra në dorëzim

(Më hollësisht trajtuar në faqet 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Drejtori i DPPGJ, të përcaktojë nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, për sa më lart janë marrë masa, referuar shkresës nr.1346 Prot. datë 05.07.2023, Lënda: “Gjurmët e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim”.

Rekomandimi është zbatuar

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”, rezulton se, Ofertat e paraqitura nga subjektet P, b) S dhe c) Ipër përlllogaritjen e Fondit limit për këtë procedurë, nuk kanë datë, dhe nuk janë shoqëruar me specifikimet teknike.

-Specifikimet teknike janë hartuar dy muaj pas marrjes së ofertave nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit.

-Në përbërjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka specialist IT, kjo në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të prokurimeve publike.

-Nga verifikimi i statusit, të subjekteve që kanë paraqitur ofertë për grupin e punës për përlllogaritjen e fondit limit, rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Subjekti i është regjistruar më datë 23/09/2020, ndërkohë që komisioni pretendon që ofertën e ka marrë në datën 17.01.2020 (data është e korrigjuar)

-Grupi i përllogaritjes së FL i DPPGJ, mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të pretenduara se ka marrë ka përllogaritur si Fond Limit të njëjtën vlerë të paraqitur në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të drejtorisë së planifikimit dhe menaxhimit.

-Pra sipas grupit të ngritur për llogaritjen e Fondit nga ana e tyre është përllogaritur e njëjta vlerë që ishte parashikuar nga AK në shkresën nr. 112/1 Prot., Datë 17.01.2020 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit

(Më hollësisht trajtuar në faqet 65-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë

Koment: *Nga verifikimi rezultoi se, me anë të shkresës Nr. 185/92 datë 26.07.2023 DPPGJ-ja i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit Bashkia Tiranë.*

Po kështu është mbajtur korrespondencë elektronike nga Titullari i DPPGJ me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në lidhje me trajnimet për punonjësit e DPPGJ-së dhe janë planifikuar trajnime në fushën prokurimit me temë “Prokurim Publik”, niveli bazë në të cilin janë trajnuar punonjësit, A.K me pozicion Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve, A.P me pozicion specialiste në sektorin e Prokurimeve, E.P në pozicionin Drejtor pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, L.L me detyrë përgjegjëse sektori në Sektorin e planifikimit në Drejtorinë e Projekteve si dhe L.H në pozicionin Specialiste në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.

Si dhe në trajnimin me temë “Detyra e sekretarisë dhe të arkivës” ku është trajnuar punonjësja E.XH me pozicion Specialist I/Arshiv pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Rekomandimi është zbatuar

19.2.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ të rris strukturën me specialist të profilit IT, të nevojshëm si gjatë fazës së hartimit të specifikimeve teknike, të DST dhe gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe marrjes në dorëzim të produkteve/shërbimeve informatike

Menjëherë

Koment: *Nga verifikimi rezultoi se, nga Titullari janë marrë masa për rekrutimin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Z. E.M me profil IT në pozicionin specialist më datë 10.11.2023.*

Rekomandimi është zbatuar

20.Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, rezulton se, AK ka kërkuar që: *Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për të gjithë artikujt objekt i procedure se prokurimit “Pjese Këmbimi, Goma, Filtra dhe Bateri”. Në pikën 7 të kriterit 2.3. në DST, AK ka kërkuar që: Operatori ekonomik duhet të garantojë që mallrat të jenë prodhim sipas standardeve BE apo/ose standardeve DOT*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Amerikan. Për te vërtetuar këtë pike te paraqitet certifikata e origjinës se mallit objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të mostrave të mallit.

Referuar udhëzimit nr.2., datë 02.05.2019., të APP mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik, KVO duhet të mbajë një proces verbal të paraqitjes së mostrave, pasi i shërben procesit të evidentimit dhe ruajtjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesi.

Mostrat e administruara duhej t'i ktheheshin ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Nga auditimi rezulton se, nuk ka evidence dokumentare, për të dokumentuar ruajtjen dhe kthimin e mostrave tek kontraktuesi pas 30 ditësh nga AK.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, rezulton se, AK DPPGJ nuk ka hartuar grafikun e shërbimeve për mjetet e transportit planifikuara për shërbime.

Proces verbal i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të këtyre shërbimeve i administruar nga grupi i auditimit të KLSH gjatë fazës së terrenit nuk evidentonte shërbimet e kryera pranë kontraktuesit sipas një grafiku të planifikuar por vetëm faktin që shërbimet janë realizuar.

Në referim të rekomandimit të APP me nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, gjatë marrjes në dorëzim për kontratat tip mallra/shërbime, rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërbenë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK. Gjate observacionit të kësaj gjetje, AK paraqiti një PV të rregullt sipas kërkesave që parashikon rekomandimi i APP, dhe si rezultat observacioni për këtë pikë u mor në konsideratë, por për të përmirësuar procesin e evidentimit të marrjes në dorëzim, Grupi i auditimit të KLSH la rekomandimin e përkatës për mos përsëritjen e parregullsisve të evidentuara gjatë fazës së terrenit nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve
(Më hollësisht trajtuar në faqet 74-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1.Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave. Drejtori i DPPGJ, të hartoj nëpërmjet akteve administrative rregulla të qarta për të mundësuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë të protokolluara dhe të administrohen nga zyra e protokoll/arkivit të DPPGJ-së sipas rregullave dhe normave arkivore në fuqi, për të mos lënë mundësi që raporte apo proces verbale të mund të gjenerohen pas afateve kohore të përcaktuara në kushtet e kontratës së shërbimit në këtë rast.

Në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, për sa më lart janë marrë masa, referuar shkresës nr.1346 Prot. datë 05.07.2023, Lënda: “Gjurmët e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim”.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Masa për shpërblim dëmi.

KLSH i ka rekomanduar DPPGj, 2 masa për shpërblim dëmi, në vlerën **4,172,200 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPGJ, Bashkia Tiranë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kolonjë në vlerën 4,172,200 lekë, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate” nga ana e grupit të auditimit në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate u realizua verifikim fizik i pajisje që ishin në inventarin e stafit të brendshëm të DPPGJ. Grupi i auditimit me përzgjedhje bëri verifikimin e modelit, dhe specifikimeve teknike të pajisjeve kompjuterave, Laptop dhe Printera, nga ku rezultoi se:

a. Për pajisjet Lap Top, kontraktuesi P nuk ka dorëzuar tipin dhe modelin e ofertuar dhe të pranuar nga AK. Pasi OE P për pajisjen LapTop ka ofertuar modelin H ndërkohë që ka dorëzuar LAP topin model H.

Komisioni i marrjes në dorëzim ngarkohet me përgjegjësi pasi ka pranuar materiale në kundërshtim me kërkesat e AK dhe ato të pranuar dhe të vlerësuar nga KVO duke pranuar një model të ndryshëm dhe me karakteristika jo të njëjta me ato të kontraktura.

b. OE P ka furnizuar AK me Monitorin modelin H dhe jo modelin e ofertuar H, të pranuar dhe shpallur fitues nga KVO.

c. OE P ka dorëzuar pranë DPPGJ, pajisjen Printer model L ndërkohë që ka ofertuar Printerin model L.

Nga auditimi rezulton se:

1.OE “P” ka dorëzuar pranë AK mallra të pa kërkuara duke mos ju përmbajtur deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6, duke pranuar se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

2.Komisioni i zbatimit të kontratës ka vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës duke konfirmuar fiktivisht realizimin e saj dhe si rezultat OE “P” ka përfituar gjithë shumën e kontratës prej 1,917,600 lekë (me TVSH) duke e liruar kontraktuesin nga detyrimi i sigurimit të kontratës në shumën 10% të saj.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 69-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: DPPGJ të ndjek të gjitha procedurat administrative për kontraktuesin P për të zëvendësuar pajisjet e konstatuara me devijime nga modeli i ofertuar me ato të dorëzuara, pasi OE P ka shkelur hapur kushtet e kontratës nr.112/15 prot. Datë 14.04.2020 dhe në rast të mos zëvendësimit të tyre, shuma **1,411,200 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e DPPGJ.

Deri më datën 31.12.2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Koment: Nga verifikimi rezulton se, deri më tani janë marrë masa, si vijon:

1. Shkresë Nr. 1475 Prot. datë 26.07.2023 me lëndë “Dërgim Informacioni mbi Raportin Përfundimtar të KLSH”
2. Nga ana e subjektit P është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentit me anë të shkresës Nr. 234 Prot. datë 19.09.2023 protokolluar pranë DPPGJ me Nr.543/2 datë 20.09.2023.
3. Nga ana e Titullarit të AK emëruar më datë 06.09.2023 pranë DPPGJ, ka vijuar me korrespondencën shkresore duke kthyer përgjigje me anë të shkresës me nr. 543/3. datë 20.09.2023 drejtuar subjektit.
4. Shkresës me nr. 543/4 datë 05.10.2023 DPPGJ-ja ka kërkuar nga subjekti zbatimin e rekomandimit.
5. Shkresë me Nr. 543/5 me datë 18.12.2023 nga ana DPPGJ ka rinjoftuar Subjektin P për zbatimin e rekomandimit.
6. P me anë të shkresës nr.311 prot. datë 27.12.2023 me lëndë: “kthim përgjigje” bën me dije DPPGJ se shkresa nr.93 prot, datë 14.04.2023, protokolluar nga DPPGJ me nr.543/1 prot. datë 14.04.2023 nuk rezulton të jetë nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i P dhe se nga ana e tyre ka nisur një hetim i brendshëm drejtuar autoriteteve për gjetjen e burimit të kësaj shkrese.

Rekomandimi është në proces

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)” rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit pranë DPPGJ, ka planifikuar një shërbim tërësor ose remont kapital për autobotin 10,000 litra. Ky planifikimi është bazuar në akt defektimin nr.8 të datës 12.01.2021 i mbajtur nga një komision i posaçëm. Në këtë akt defektimi komisioni i sipërcituar ka kërkuar të kryen shërbime për zëvendësimin e bllokut të motorit cilindër testat, riparim injektorësh + pomp naftë, fv. pistocina freni, fv. tamburo frenimi, fv kambio komplet, fv pompe frenash, fv radiator uji, fv koke paraleli, fv koke zbarë.

Shërbimi është kërkuar nga komisioni i verifikimit të defekteve, se sipas tyre ky mjet është i amortizuar. Por nga auditimi i procedurës se blerjes se këtij mjeti rezulton se ky është blerë i ri dhe ka kryer vetëm **13,761 km**, duke mos justifikuar kërkesën për remont kapital.

-Akt Defektimi nr.8 të datës 12.01.2021, nuk është firmosur nga shoferi që e përdor autobotin 10,000 litra, i cili nuk ka paraqitur asnjë shqetësim në lidhje me defektet që ka konstatuar komisioni.

Referuar ofertës ekonomike të kontraktuesit, shërbimet e kryera për mjetin A, i kanë kushtuar buxhetit të DPPGJ **2,761,000 lekë**, shumë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar dhe të shprehur në qëndrimin e grupit të auditimit të KLSH, në përgjigje të observacionit të paraqitur nga subjekti për Projekt Raportin e Auditimit të KLSH për këtë çështje, duke ngarkua me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të gjendjes së këtij mjeti nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 79-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: DPPGJ të kërkoj nga subjekti fizik/juridik i licensuar në fushën e ekspertizës për shërbimet mekanike për automjetet, i cili ka mbajtur Akt verifikimin nr.544/1 datë 07.04.2023 gjithë dokumentacionin që vërteton që është i licensuar për objektin e verifikimit. Ky dokumentacion shtesë duhet të jetë plotësuar brenda afateve kohore të raportimit të zbatimit të rekomandimeve për KLSH, në rast të mos plotësimit të këtij kushti



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

shuma prej **2,761,000 lekë**, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi në mënyrë proporcionale, përgjegjësin e sektorit të oficinës, anëtarët e komisionit të verifikimit të defekteve që kanë hartuar akt defektimin nr. 8 datë 12.01.2021 dhe përgjegjësin e sektorit Flota Transport pranë DPPGJ.

Deri më datën 31.12.2023

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, me shkresë nr. 185/93, datë 26.07.2023 dhe nr. 185/100, datë 18.01.2023, DPPGj ka njoftuar kërkuar nga z. A.B plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe në rast të kundërt shpërblimin e dëmit nga përgjegjësit. Me shkresë datë 27.12.2023, z. B ka dorëzuar pranë DPPGj dokumentacionin e noterizuar me Nr. Rep 24232, datë 27.12.2023 dhe konkretisht “Dëshmi Aftësie Profesionale” dhe Diplomë.

Rekomandimi është zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet

KLSH i ka rekomanduar DPPGj, 10 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1-6 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 (gjashtë) procedurave të prokurimit për vitin 2018-2021 me vlerë të fondit limit 32,034,873 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike.

1.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje Speciale” viti 2018, me fond limit 3,450,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE G shpk, me vlerë oferte 3,275,833 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 3,275,833 lekë pa Tvsh;

2.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2019, me fond limit 6,650,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE R, me vlerë oferte 6,610,100 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 6,610,100 lekë pa Tvsh;

3.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Uniforma dhe Veshje të tjera Speciale” viti 2019, me fond limit 4,950,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE G shpk, me vlerë oferte 4,785,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,785,000 lekë pa Tvsh;

4.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Dezinfektim i sipërfaqeve publike, stola, kosha, lulishte, etj.” viti 2020, me fond limit 5,000,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “Pastrime Silvio” shpk, me vlerë oferte 4,995,000 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,995,000 lekë pa Tvsh;

5.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2020, me fond limit 6,666,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE R, me vlerë oferte 6,646,200 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 6,646,200 lekë pa Tvsh;

6.Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizime dhe Materiale të tjera Zyre” viti 2021, me fond limit 5,833,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE R, me vlerë oferte 5,722,740 lekë pa Tvsh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,722,740 lekë pa Tvsh. (Më hollësisht trajtuar në faqet 105-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1-1.6 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, Titullari i DPPGj ka ngritur Urdhrin Nr.185/84 Prot. datë 29.06.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve C1.1-1.6”, ku është ngritur komisioni për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin jo të saktë të ofertave. Në përgjigje të Urdhrit të mësipërm, nga komisioni është kthyer përgjigje me për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive me shkresën nr. 185/89 datë 20.07.2023 në të cilën janë identifikuar përgjegjësitë dhe është vijuar me propozimin e masave disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negativ të buxhetit të shtetit me vlerë 1,189,575 lekë me tvsh.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 119-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune i cili do të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,189,575 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, Titullari i DPPGj ka ngritur Urdhrin nr.185/85 Prot. datë 29.06.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve C 2.1”, me përbërjen e komisionit që do të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për efektin financiar negativ në buxhet. Komisioni i mësipërm nëpërmjet shkresës nr.185/90 Prot. datë 21.07.2023, ka analizuar dhe ka nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së auditimit “Drurë dhe shkurre dekorative” në lidhje me dokumentacionin teknike të zbatimit, situacionin përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,660,320 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 139-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 1,660,320 lekë me tvsh.

Menjëherë

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, ish Titullari i DPPGj ka nxjerrë Urdhrin nr. nr.185/95 datë 14.08.2023, për ngritjen e komisionit i cili do të realizojë evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve, por nga ky komision nuk janë marrë masa për zbatimin e urdhrin. Në vijim, konstatohet se me shkresë nr. 185/99 prot, datë 18.12.2023 është kërkuar nga Titullari i ri i DPPGj informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga ku konstatohet se komisioni i ngritur nuk ka patur dijeni për detyrën e ngarkuar dhe as për raportin e KLSH, shprehur kjo me shkresë nr. 22/1 prot, datë 04.01.2024.*

Rekomandimi është në proces

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikualifikim i mikrohapësirave të gjelbra” në lidhje me dokumentacionin teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacioneve si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 37,480 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 147-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 37,480 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, ish Titullari i DPPGj ka nxjerrë Urdhrin nr. 185/94 datë 14.08.2023, për ngritjen e komisionit i cili do të realizojë analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përdorimin pa efektivitet të fondeve, por nga ky komision nuk janë marrë masa për zbatimin e urdhrin. Në vijim, konstatohet se me shkresë nr. 185/101Prot. datë 18.12.2023 është kërkuar nga Titullari i ri i DPPGj informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga ku konstatohet se komisioni i ngritur nuk ka patur dijeni për detyrën e ngarkuar dhe as për raportin e KLSH, shprehur kjo me shkresë nr. 185/104 prot, datë 21.12.2023.*

Rekomandimi është në proces

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 1,137,720 lekë me tvsh. (Më hollësisht trajtuar në faqe 161-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë, të marrë masat për ngritjen e një grupi pune që të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë prej 1,137,720 lekë me tvsh, vlerë e cila nuk argumentohet apo justifikohet.

Menjëherë

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, ish Titullari i DPPGj ka nxjerrë Urdhrin nr. 185/94 datë 14.08.2023, për ngritjen e komisionit i cili do të realizojë analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përdorimin pa efektivitet të fondeve, por nga ky komision nuk janë marrë masa për zbatimin e urdhrin. Në vijim, konstatohet se me shkresë nr. 185/101Prot. datë 18.12.2023 është kërkuar nga Titullari i ri i DPPGj informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga ku konstatohet se komisioni i ngritur nuk ka patur dijeni për detyrën e ngarkuar dhe as për raportin e KLSH, shprehur kjo me shkresë nr. 185/104 prot,datë 21.12.2023.*

Rekomandimi është në proces

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Blerje drurë dhe shkurre dekorative” referuar dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje rezultuan se kanë sjellë një efekt negative të buxhetit të shtetit me vlerë 2,061,360 lekë me tvsh. (Më hollësisht trajtuar në faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë së drurëve që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 2,061,360 lekë me tvsh.

Menjëherë

***Koment:** Nga verifikimi rezultoi se, ish Titullari i DPPGj ka nxjerrë Urdhrin nr. 185/95 datë 14.08.2023, për ngritjen e komisionit i cili do të realizojë analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përdorimin pa efektivitet të fondeve, por nga ky komision nuk janë marrë masa për zbatimin e urdhrin. Në vijim, konstatohet se me shkresë nr. 185/99 prot, datë 18.12.2023 është kërkuar nga Titullari i ri i DPPGj informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga ku konstatohet se komisioni i ngritur nuk ka patur dijeni për detyrën e ngarkuar dhe as për raportin e KLSH, shprehur kjo me shkresë nr. 22/1 prot,datë 04.01.2024.*

Rekomandimi është në proces

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)” nga auditimi i dokumentacionit teknike të zbatimit, situacioni përfundimtar (relacion / situacionet e brendshme) dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, për zonat e audituara me përzgjedhje nga audituesit rezultuan mungesa të koshave dhe mos evidentimin e sasisë dhe vlerës së punimeve, veprime të cilat kanë sjellë që ka sjellë përdorim jo efektiv të fondeve. (Më hollësisht trajtuar në faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e sasisë që mungojnë në të gjithë kontratën dhe evidentimin e shkaqeve që ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve, dhe përcaktimin e vlerës së evidentuar pa efektivitet.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, ish Titullari i DPPGj ka nxjerrë Urdhrin nr. 185/96 datë 14.08.2023, për ngritjen e komisionit i cili do të realizojë analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përdorimin pa efektivitet të fondeve, por nga ky komision nuk janë marrë masa për zbatimin e urdhrin. Në vijim, konstatohet se me shkresë nr. 185/98 prot, datë 18.12.2023 është kërkuar nga Titullari i ri i DPPGj informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit, nga ku konstatohet se komisioni i ngritur nuk ka patur dijeni për detyrën e ngarkuar dhe as për raportin e KLSH, shprehur kjo me shkresë nr. 185/103 prot, datë 21.12.2023.

Rekomandimi është në proces

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra” rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit ndër të tjera, ka kërkuar edhe blerjen e artikujve “Motorino” dhe “Dinamo”. Në referim të procedurës së prokurimit “Shpenzime për te tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje e mjeteve)”, rezulton se:

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit në DPPGJ, më datën 08.02.2021 kishte planifikuar FV dinamo dhe FV motorino.

Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit me datë 16.02.2021, ka planifikuar përsëri FV dinamo dhe motorino për procedurën me objekt “Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra”.

Pra, Drejtoria e planifikimit dhe menaxhimit në DPPGJ, brenda harkut kohor të një jave ka planifikuar dhe miratuar FV për Dinamo dhe Motorino në dy procedura prokurimi të ndryshme të zhvilluar në të njëjtën periudhë.

Objekti i procedurës së prokurimit “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, nuk parashikon blerjen e “dinamove” dhe “motorinove”, por vetëm blerje të gomave, baterive dhe filtrave.

OE Gajd., i shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri dhe Filtra”, për FV Dinamo dhe Motorino ka ofertuar shumën **270.000 lekë.**, e cila do të konsiderohet shpenzim pa efektivitet nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ, Bashkia Tiranë.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë të marrë masa që gjatë hartimit të regjistrin të parashikimeve të prokurimeve publike të mos bëhet copëzim fondi. Mallrat apo grup mallrat duhet të grupohen sipas funksionit me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit dhe përdorimin e fondeve me efektivitet në përputhje me aktet ligjore në fuqi në fushën e prokurimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, me shkresë nr.92 Prot. datë 13.01.2023, me të dcilën është miratuar Regjistri i Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik të DPPGJ për vitin 2023, nuk konstatohen procedura prokurimi me natyrë të ngjashme dhe të copëzuara.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”, në SPE, rezultoi se, G i kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO nuk plotësonte kriterin 2.2 pika a (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) dhe si rezultat G i shpallur padrejtësisht fitues nga KVO duhej të s’kualifikohej.

***Referuar PV të KVO të datës 12.06.2020, rezulton se:

KVO ka s’kualifikuar OE L, pasi ky OE nuk plotësonte kriteret e mëposhtme:

1.OE L nuk ka firmën e përkthyesit tek dokumentacioni i paraqitur, e gjithashtu nuk është e qartë çfarë dokumenti është përkthyer pasi nuk cilësohet në dokumentacionin e paraqitur.

Më tej gjuha tek vërtetimi i përkthimit i datës 10/06/2020 Nr. REP 5319 nuk është gjermanisht (deutsch) por hollandisht (dutch) tek librezat e qarkullimit të paraqitura.

Gjithashtu ka mospërputhje në përkthim tek mjeti Autokullë (Platformë Pune) pasi në anglisht çmimi është 32,000 Euro ndërsa në shqip është 30,500 Euro.

2.Gjithashtu të gjitha marrëveshjet apo kontratat që OE L pretendon se ka nënshkruar me OE të huaj nuk përmbajnë datë në asnjë prej rasteve.

3.OE L nuk përmbush pikën 4 të specifikimeve teknike pasi kamionçinat e paraqitura të markës R me numër shasie përkatësisht (V) dhe (V) nuk janë të llojit vetë-shkarkuese në asnjërin prej rasteve në dokumentacionin e paraqitur, siç edhe janë kërkuar nga AK në dokumentat e tenderit.

Kamionçinat nuk janë vetë-shkarkuese pra nuk janë të llojit kipper siç edhe cilësohet në gjuhë hollandeze nëse ato do të ishin të tilla.

4.OE L nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit teknik pasi pas verifikimeve të kryera nga ana e KVO mbi dokumentacionin e dërguar dhe specifikisht për mjetin R me nr. shasie (V), mjeti nuk rezulton të ketë bërë 125,595 km.

5. OE L nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik në lejen e qarkullimit të mjetit Autokullë (Platformë Pune) ku shkruhet se është dy metra i gjerë ndërkohë që në përkthim të kontratës është 1.8 metra. Gjithashtu sipas specifikimeve teknike kulla kërkohet të jetë maksimumi 1.9 metra e gjerë ndërkohë që është 2 metra e gjerë sipas librezës së qarkullimit. Gjithashtu nuk përmbush specifikimet teknike pasi gjatësia është 5,522 mm (ose 552,2 cm) ndërkohë që sipas specifikimeve teknike gjatësia duhet të jetë 450-500 cm.

6. OE L nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik pasi kamionçinat janë 3,500 kg ndërkohë që nga AK janë kërkuar 2900-3400 kg.

7. Mos-përputhje nga dokumentacioni i paraqitur për kamionçinën R me numër shasie përkatësisht (V) ku vëllimi i paraqitur tek dokumentat e përkthyer nuk korrespondon me atë të paraqitur në lejen e qarkullimit, ku specifikisht në dokumentacionin e përkthyer të paraqitur është 2,298 cm³ ndërkohë që në lejen e qarkullimit është 2,299 cm³.

Për sa më lart, KVO duhej të s’kualifikonte OE G dhe në kushtet që kishte s’kualifikuar OE L, kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej nga e para.

Megjithese OE L ishte i renditur i pari për nga oferta ekonomike është s’kualifikuar nga KVO. Gjithashtu edhe OE G i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt nga KVO duhej të s’kualifikohej për mosplotësim të disa kriterëve të sipërcituar.

Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurën, pasi të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratuara nga titullari i institucionit. Diferenca midis ofertës më të ulët dhe ofertës së vendit të dytë të kualifikuar dhe shpallur fitues në shumën 1,593,600 lekë, do të konsiderohet përdorim pa efektivitet për buxhetin e DPPGJ. (Më hollësisht trajtuar në faqet 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit duhet të bëjë kujdes dhe të përcaktoj kriteret të qarta dhe lehtësisht të verifikueshme të cilat duhet të respektojnë gjithë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor të prokurimeve publike në fuqi, duke përdorur me eficence fondet buxhetore në dispozicion dhe të nxjerr përgjegjësi për anëtarët e KVO për shumën **1,593,600 lekë**, të përdorur pa efektivitet nga buxheti i DPPGJ.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGJ pas raportit Përfundimtar të KLSH ka ngritur Urdhërin nr.185/86, datë 29.06.2023, “Për zbatimin e Rekomandimeve pika nr. C 9.1” sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit” me anë të të cilit është ngritur komisioni për analizimin e procedurës dhe marrjen e masave për antarët e KVO. Me shkresë nr.185/91 Prot. datë 24.07.2023, nga komisioni është kryer shqyrtimi i shkeljeve në këtë procedurë si dhe janë propozuar masat disiplinore për KVO.

Rekomandimi është zbatuar

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi “Blerje Mjete Transporti” rezulton se, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE G., i renditur i dyti për nga vlera e ofertës ekonomike, dhe ne kushtet që nuk plotëson disa nga kriteret e DST të sipërpërmendura. Në këto kushte KVO, duhej ta s’kualifikonte OE G.

KVO duhej të s’kualifikonte OE G dhe në kushtet që kishte s’kualifikuar BOE R&L, kjo procedurë duhej të anulohet dhe të përsëritej.

KVO ka s’kualifikuar BOE R&L të renditur të parët për nga oferta ekonomike, gjithashtu KVO, për sa trajtuar në materialin e auditimit në këtë Raport Përfundimtar duhej të skualifikonte edhe OE G të cilin e ka kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt, në këto kushte kjo procedurë duhej të anulohet, pasi të dy OE pjesëmarrës nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST të miratura nga titullari i institucionit. Për sa më lart, Diferenca midis ofertës më të ulët dhe vendit të dytë në shumën 3,066,660 leke (pa TVSH) ose **3,679,992 lekë (me TVSH)**, do të konsiderohet **përdorim pa efektivitet** i buxhetit të DPPGJ, Bashkia Tiranë. (Më hollësisht trajtuar në faqet 61-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit Gjellbërimit të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për antarët e KVO të cilët kanë vepruar hapur në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të DPPGJ në shumën 3,679,992 lekë.

Menjëherë

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, DPPGJ pas Raportit Përfundimtar të KLSH ka ngritur Urdhërin e Brendshëm nr.185/87 prot, datë 29.06.2023, “Për zbatimin e Rekomandimeve pika nr. C 10.1” me anë të të cilit është ngritur komisioni për analizimin e procedurës dhe marrjen e masave për antarët e KVO. Me shkresë nr. 185/88 Prot. datë 17.07.2023 nga komisioni është kryer shqyrtimi i shkeljeve në këtë procedurë si dhe janë propozuar masat disiplinore për KVO.

Rekomandimi është zbatuar

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar DPPGj, 31 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Ligjit nr. 152/2013; Për nëpunësin civil, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Pastrim Gjelbërimit, Bashkia Tiranë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1. Z. V.L, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit

2. Z. I.M, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit

-Në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të oficinës për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

3. Z. E.Xh, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti dhe Agregat”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 52-56 të Raportit të Auditimit

-Në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.16 faqe 154-156 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 167-168 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 86-87 të Raportit të Auditimit

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

4. Z. A.Q, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

5. Z. G.R, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit “Blerje Mjete Transporti”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.2 faqe 61-63 të Raportit të Auditimit

6. Znj. A.K, në cilësinë e komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

7. Z. E.Xh, në cilësinë e komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

8. Z. R.O, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

9. Z. G.M, në cilësinë e përgjegjës të sektorit Flota Transport për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

10. Z. A.T, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

11. Z. E.V, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

12. Z. K.M, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

13. Z. A.D, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të defekteve nëpërmjet akt detektimit nr.8 datë 12.01.2021., për procedurën “Shpenzime të tjera Materiale dhe Shërbime Operative (Mirëmbajtje e Mjeteve)”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.5 faqe 78-80 të Raportit të Auditimit

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

14. Z. M.M, në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale” (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.6 faqe 86-87) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.18 faqe 180-182) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.17 faqe 167-168) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.16 faqe 154-156 të Raportit të Auditimit.

15. Znj. I.Al, në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën : “Uniforma dhe Veshje Speciale”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 86-87 të Raportit të Auditimit

16. Z. B.D, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.12 faqe 117-119 të Raportit të Auditimit

17. Znj. A.N, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.12 faqe 117-119) të Raportit të Auditimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Aparate”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 71-72 të Raportit të Auditimit

18. Znj. A.L, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Shërbime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.12 faqe 117-119 të Raportit të Auditimit

19. Z. A.S, në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.14 faqe 137-139 të Raportit të Auditimit

20. Z. E.M, në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.14 faqe 137-139) të Raportit të Auditimit)

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

21. Z. H.H, në cilësinë e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për procedurën “Drurë, shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.14 faqe 137-139 të Raportit të Auditimit

22. Znj. N.Gj, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

23. Z. I.F, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit

24. Znj. M.M, në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën “Rikualifim i mikrohapësirave të gjelbërta”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.15 faqe 147-148 të Raportit të Auditimit

25. Z. M.B, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave për procedurën “Rikonstruksioni i lulishteve dhe mikrohapësirave të gjelbra me shatërvane në blloqe banimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4.16 faqe 154-156) të Raportit të Auditimit)

-Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 167-168 të Raportit të Auditimit

26. Z. A.B, në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

27. Z. R.J, në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

28. Z. A.K, në cilësinë e anëtarit të komisionit të zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje drurë dhe shkurre dekorative”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.17 faqe 172-175 të Raportit të Auditimit

29. Z. J.P., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 180-182 të Raportit të Auditimit

30. Z. R.M., në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të kontratave për procedurën “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe (180-182) të Raportit të Auditimit

31. Z. M.Gj., në cilësinë e anëtarit të komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Shpenzime e për të tjera materiale dhe shërbime operative (mirëmbajtje kosha, stola dekorativ)”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.18 faqe 183-185 të Raportit të Auditimit

Koment: Nga verifikimi rezultoi se, nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e masave disiplinore të rekomanduara, është konkluduar dhe vijuar me marrjen e masës Disiplinore “Vërejtje” me Urdhra të Titullarit më datë 06.06.2023, me nr. rendor Prot 185/57 - 185/79.

Rekomandimi është zbatuar

Përmbledhëse e Masave

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pa zbatuar (Pa filluar procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
I	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	26	26	20	1	-									
I	MASA SHPËRBLIM DËMI	2	2	1	-	-	4,172		4,172		2,761	1,411		-	
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
I	MASA DISIPLINORE	31	31	31	-	-									
	(Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil														
V	MASA 3E	10	10	5	-	-	43,661		43,661	10	38,766	4,895		-	
	Nga të cilat:														
	Të ardhura të munguara														
V	Dhe të tjera masa nëse ka Gjaba APP														

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në DPPGJ, Bashkia Tiranë rezulton se subjekti i audituar **ka respektuar** afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, **ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave me shkresë nr. 1008/13, datë 19.01.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë”

ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

9.1 Rekomandimi: DPPGj, Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e saktë të dokumentacionit justifikues për kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës nga ana e kontraktorit.

Menjëherë

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËRORË TË KLSH-së

R.K(Përgjegjës grupi)

E.K

F.Ç

M.M

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K.Gj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUdhËN
01.01.2023 DERI 30.06.2022, NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJT,
BASHKIA TIRANË”**

Tiranë 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit	5
I/4. Metodologjia e Auditimit	5
I/5. Konkluzioni	6
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJT, BASHKIA TIRANË	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	12



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në 6 subjekte, respektivisht: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Njësia Administrative Dajt, Njësia Administrative Petrelë, Njësia Administrative Farkë dhe Njësia Administrative Zall-Herr (Bashkia Tiranë): “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve:

Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 796/31 datë 16.06.2023 **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditës.

-9 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 9 prej tyre, nga ku 9 masa rezultojnë pa zbatuar.;

-1 masë disiplinore, për të gjithë punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, e cila rezulton e pazbatuar.

I/1. Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 191/7 prot., datë 20.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 25.03.2024, u krye auditimi në Njësinë Administrative Dajt, Bashkia Tiranë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **R.K** - Përgjegjës grupi
2. **E.K** - Anëtare
3. **F.Ç** - Anëtar
4. **M.M** - Anëtar

Cështjet e Audituar:

1. Hartimi i programit (*Plan veprimt*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në NJ.A DAJT me shkresën nr. 796/31, datë 16.06.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezulton se Nj.A Dajt nuk kanë filluar të merren masa lidhur me zbatimin e 9 rekomandimeve organizative dhe 1 mase disiplinore të lënë, të cilat janë pranuar nga Nj.A Dajt.

Masa organizative

Nga 9 masa organizative, nuk është zbatuar asnjë masë.

Masa Disiplinore

Nga 1 masë disiplinore e lënë, nuk është zbatuar asnjë masë.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 0% si numër, gjë e cila tregon se nga subjektet nuk është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve dhe nuk janë ndërmarrë angazhime për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në bashkëpunim me Autoritetin përgjegjës për realizimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJT, BASHKIA TIRANË

1. Auditimi i fundit në Njësinë Administrative Dajt, Bashkia Tiranë

Auditimi i fundit në Nj.A Dajt, Bashkia Tiranë është kryer në vitin 2023 për periudhën 01.01.2019-30.08.2022, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 796/31 datë 16.06.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 9 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Nj.A Dajt duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, NJ.A DAJT për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 796/31 datë 16.06.2023 nuk **ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditës, por rezulton se është hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

Referuar shkresës nr. 796/31 datë 16.06.2023, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”. Sipas verifikimit Nj.A Dajt, Bashkia Tiranë **ka kthyer përgjigje** në KLSH me shkresën nr. 796/33 datë 30.10.2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Nj.A Dajt ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 796/33 prot., datë 30.10.2023, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Nj.A Dajt.

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar NJ.A DAJT 9 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. H.D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, pa verifikuar formularin nr.6, nëse ngastra me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë dhe shtatë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² dhe 1270 m² në llojin e pasurisë “Arë”, përputhet me AMTP-në me nr.Akti 128, datë 08.04.2003, si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative për Fshatin Linz, hartën e ish-kooperativës bujqësore të shk. 1:5000, hartën e shk. 1:2500, dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë e llojit të pasurisë, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, të kërkoje pranë DV ASHK Rurale 1, anulimin e regjistrimit të dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021, për regjistrimin e pasurisë “pyll” në emër të z. H.D, ku pasuria nr. Pasurie 505/361, regjistruar në vol.64, faqe 11, Z.K. 2460 nga lloji i pasurisë “pyll” më sipërfaqe 2250 m², Fshati Linz, të rikthehet në pasuri “shtet”

Menjëherë

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast nga Administratori i Njësisë Administrative Dajt është dërguar AMTP-ja “Dublikatë” direkt për regjistrim, pa kaluar më parë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, ku në formatin e formularit të AMTP-së **Dublikatë** mungon



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

miratimi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që do të thotë se në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurës Administrative”, është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i miratimit të AMTP-së Dublikatë (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me titujve të rinj të pronësisë mbi tokën mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Dajt duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**

3. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste, Njësia Administrative Dajt ka përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit nuk është hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke mos përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**

4. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. Sulejman Meta për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar më parë vlefshmërinë e ngastrës me emërtimin popullor “ullishte”, që bazuar në “kthim përgjigje të DV ASHK Tirana Rurale 1, rezulton në llojin e pasurisë tokë “Pyll”, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimit për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr. 6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Njësia Administrative Dajt në vazhdimësi ka llogaritur si të ardhura nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m², çfarë do të thotë se 30 rrënjë ullinj që posedon Z. M.E, është e barabartë me (max.) 3600 m², (120 m² x 30 rrënjë ullinj = 3600 m²), ndërsa kërkesën e Z. R.E është miratuar me sipërfaqe 5960 m² sipas Plan rilevimit i hartuar me datë 15.02.2021 nga topografi i Njesisë Administrative Dajt i konfirmuar nga Përgjegjësi i ZMMT dhe i miratuar nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet të përdorë një standard në llogaritjen e të ardhurave nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m²

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkalluar normën për frymë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, përfituesi i AMTP-së, i plotësuar në emër të **znj. N.B** nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Tufinë, nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. Bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje, rezulton se familja bujqësore nuk ka qenë banore në territorin e i fshatit Tufinë, por është banore e fshatit Zall-Bastarë, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë legjitimitetin e AMTP-së në lidhje me përfitimimin e tokës bujqësore, sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**

8. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit nuk ka saktësuar pasurinë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1, duke copëzuar pasurinë nr. 364/4 në tre pasuri të tjera “shtet”, krejtësisht të pashfrytëzueshëm, duke marr një konfigurim krejtësisht të ndryshëm nga fragmenti i hartës kadastrale, në kundërshtim me nenit 36, pika "b", të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të miratohet plan rilevimit e përgatitur nga topografi me licencë, të verifikohet pasuria sipas terrenit dhe të shoqërohet me deklarata noteriale sipas rastit.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**

9. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast mungon statusi juridik i pronës të pretenduar nga z. S. M. e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr. 322 për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emri figuron e hapur kartela e pasurisë së paluajtshme. Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt, nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për ngastrën me pasurinë nr. 322 me zë kadastral “truall” me sipërfaqe 20700 m² në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, të verifikohet AMTP-ja, ku sipërfaqe e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përmbushë njëkohësisht, t'i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar Nj.A Dajt, 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**

Përmbledhëse e Masave

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pjesërisht (Pa filluar procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	9	9	0	0	9									
III	MASA SHPËRBLIM DËMI														
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV	MASA DISIPLINORE	1	1	0	0	1									
	(Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil														
V	MASA ËE														
	Nga të cilat:														
	Të ardhura të munguara														
VI	Dhe të tjera masa nëse ka Gjaba APP														

Observacionet e subjektit: Me shkresë nr. 854/1, datë 30.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 191/17, datë 07.05.2024, NjA Dajt ka dërguar observacione mbi projekt raportin me pretendimin se rekomandimet e lëna nga auditimi i më parshëm nuk janë në fushën e përgjegjësisë së kësaj Njësie. NjA Dajt nuk ka tagër në përmirësimin e legjislacionit, pasi që me ligjin 20/2020, kjo Njësia ka dalë nga procedurat e AMTP-ve, pasi kjo kompetencë i ka kaluar ASHK. Rekomandime për shpërblimin e dëmit ekonomik nuk ka patur pasi fokusi i auditimit tematik ka qenë saktësia e lëshimit të AMTP-ve. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore i takon Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Për



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

sa i përket afatit 6 mujor të raportimit për zbatimin e rekomandimeve, ka qenë një proces në bashkëpunim me ASHK dhe zbatimi i tyre varet nga mirëkuptimi i ASHK.

Qendrimi i grupit të auditimit: Lidhur me sa trajtuar në shkresën observuese nga ju vemë re se kundërshtoni gjetjet e Raportit të Auditimit të kaluar dhe këto observime duhet të ishin pjesë e atij Raporti. Grupi i auditimit ka verifikuar masat e marra nga ju lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ai auditim, nga ku ka rezultuar se NjA Dajt nuk ka adresuar rast pas rasti në ASHK apo instanca të tjera përkatëse problematikën e konstatuar dhe mënyrën e zgjidhjes së rasteve të konstatuara në shkëlje. Lidhur me masat për shpërblim dëmi për të cilat shpreheni se nisur nga tematika e auditimit nuk ka patur të tilla, grupi i auditimit nuk ka përmendur në asnjë rast se ka dëm ekonomik dhe ky fakt nuk gjendet as në Projekt raportin e dërguar. Sa i takon kompetencave për masat disiplinore, sqarojmë se KLSH për këtë rekomandim i është drejtuar me shkresë më vetë Bashkisë Tiranë dhe për sa kohë nuk është zbatuar, do ti rikërkohet përsëri kësaj Bashkie.

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në NJ.A DAJT, Bashkia Tiranë për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 796/31 prot., datë 16.06.2023, rezulton se subjekti i audituar **nuk ka respektuar** afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, por **ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, me shkresën me nr. 796/33, datë 30.10.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 796/31 prot., datë 16.06.2023, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, të kërkoje pranë DV ASHK Rurale 1, anulimin e regjistrimit të dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021, për regjistrimin e pasurisë “pyll” në emër të z. H.D, ku pasuria nr. Pasurie 505/361, regjistruar në vol.64, faqe 11, Z.K. 2460 nga lloji i pasurisë “pyll” më sipërfaqe 2250 m², Fshati Linz, të rikthehet në pasuri “shtet”

2.1. Rekomandimi: Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me titujve të rinj të pronësisë mbi tokën mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Dajt duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

3.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

4.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimin për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr. 6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkalles 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

5.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet të përdorë një standard në llogaritjen e të ardhurave nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m².

6.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

7.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë legjitimitetin e AMTP-së në lidhje me përfitimim e tokës bujqësore, sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore

8.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të miratohet plan rilevimin e përgatitur nga topografi me licencë, të verifikohet pasuria sipas terrenit dhe të shoqërohet me deklaratat noteriale sipas rastit.

9.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njësia Administrative Dajt, të verifikohet AMTP-ja, ku sipërfaqe e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përbushë njëkohësisht, t'i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

1. Rekomandim: Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë”

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËRORË TË KLSH-së

R.K (*Përgjegjës grupi*)

E.K

F.Ç

M.M

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K.Gj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2023 DERI 30.06.2022, NJËSIA ADMINISTRATIVE FARKË,
BASHKIA TIRANË”**

Tiranë 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit	5
I/4. Metodologjia e Auditimit	5
I/5. Konkluzioni	5
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FARKË, BASHKIA TIRANË	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	12



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në 6 subjekte, respektivisht: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Njësia Administrative Farkë, Njësia Administrative Petrelë, Njësia Administrative Farkë dhe Njësia Administrative Zall-Herr (Bashkia Tiranë): “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve:

Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 796/30 datë 16.06.2023 **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh për dërgimin e planit të masave.

-11 masa organizative të cilat janë pranuar nga subjekti, rezultojnë pa zbatuar;

-1 masë disiplinore, për të gjithë punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezulton e pazbatuar.

I/1. Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 191/7 prot., datë 20.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 25.03.2024, u krye auditimi në Njësinë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R.K - Përgjegjës grupi
2. E.K - Anëtare
3. F.Ç - Anëtar
4. M.M - Anëtar

Cështjet e Audituar:

1. Hartimi i programit (*Plan veprimit*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në NJ.A Farkë me shkresën nr. 796/30, datë 16.06.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se NJ.A Farkë nuk kanë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

filluar të merren masa lidhur me zbatimin e 11 masave organizative dhe 1 mase disiplinore të lënë, të cilat janë pranuar nga Nj.A Farkë.

Masa organizative

Nga 11 masa organizative, nuk është zbatuar asnjë masë.

Masa Disiplinore

Nga 1 masë disiplinore e lënë, nuk është zbatuar asnjë masë.

Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, rezulton se:

Nga gjithsej **12** masa (*organizative dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 12 masa ose 100%. Nga të pranuarat nuk janë zbatuar 12 masa ose 100%.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 0% si numër, gjë e cila tregon se nga subjektet nuk është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve dhe nuk janë ndërmarrë angazhime për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në bashkëpunim me Autoritetin përgjegjës për realizimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FARKË, BASHKIA TIRANË

1. Auditimi i fundit në Njësinë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë

Auditimi i fundit në Nj.A Farkë, Bashkia Tiranë, është kryer në vitin 2023 për periudhën 01.01.2019-30.08.2022. Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 796/30 datë 16.06.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 11 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Nj.A Farkë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, NJ.A FARKË për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 796/30 datë 16.06.2023 nuk **ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditës, por rezulton se është hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 796/31 datë 16.06.2023, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 muaj për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve*



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

të dhëna”. Sipas verifikimit Nj.A Farkë, Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 796/35 datë 12.02.2023.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Nj.A Farkë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 796/30 prot., datë 16.06.2023, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në Këshillin e Njesisë.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Nj.A Farkë.

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar NJ.A Farkë 11 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste nga Administratori i Njesisë Administrative Farkë është dërguar AMTP-së “**Dublikatë**” nëpërmjet Sektorit të AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, konkretisht:

- Dokumentacionit i përcjell në emër të **z. F.B**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni i fshatit Lundër
- Dokumentacionit i përcjell në emër të **z. P.A**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër.
- Dokumentacionit i përcjell në emër të **z. J.A**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër, në kundërshtim me piken 21.2 VKM nr.1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësisë të rinj mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Farkë duhet të dërgojë AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar** .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

2. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste nga Njësia Administrative Farkë është përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, i cili nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ish-ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Farkë është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës të trashëgimtarëve të familjes K pa pasur një prokurë të posaçëm të trashëgimtarëve ligjorë për z. A.Ç, në lidhje me veprimet ligjore që do të kryhen në Njësia Administrative Farkë dhe në ZVRPP Tiranë, çfarë do të thotë se personi nuk është i legjitimuar për paraqitjen e kërkesë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë mos të pranohen kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës jashtë rrethit familjar të përfituesit të tokës bujqësore, ose pa pasur një prokurë të posaçme të trashëgimtarëve ligjor.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

5. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqja e përfitur me AMTP prej 1900 m² si tokë bujqësore në llojin e pasurisë “arë” ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë “truall” e për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatin Shkozë ka vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 452, date 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfitur tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfitur tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin 20/2020 dhe ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste, nga specialisti ZAMIT-t të Njesisë Administrative Farkë nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është referuar pasurisë sipas hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njesisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa për saktësim harte, duhet të verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë, ndryshimet e ndodhura pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

7. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste, formulari i kërkesës që qytetari ka paraqitur pranë zyrës së informacionit të Njesisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Nëpunësi i zyrës së pritjes pranë Njesisë Administrative Farkë të pranojë kërkesa për vazhdimin e procedurës për regjistrim, të konfirmuar vetëm nga personi kërkuar.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Njesisë Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për Hasan Mexhit Hidri, pa pasur më parë një deklaratë noteriale të shtetasit D.P në lidhje me pasurinë nr. 182/5, që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë “vreshtë” me sipërfaqe prej 2362 m² në emër të D.P, që krijon mbivendosje pasurie, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njesisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa nga saktësim harte të shoqërohet më deklaratë noteriale me kufitarët e pasurisë që do të saktësohej.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste, pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bien mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme”, mbi pasuri “rrugë” dhe mbi pasuri “pyll”, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

9.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimin për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkalles 1:5000 para vitit 1991, për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

10. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, relacioni shpjegues i administruar në dosje i konspektuar nga specialisti ZMMT-së, i konfirmuar nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimeve Publike dhe i miratuar nga Administratori i Njesisë Administrative, janë pa datë miratimi dhe pa numër protokollit, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njesisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur dokumentacioni shoqërohet me Relacion Shpjegues, kjo e fundit të protokollohet pranë zyrës së protokollit.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

11. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së, të kërkoje nga poseduesi i tokës bujqësore vërtetimin nga zyra e taksave dhe e tatimeve për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

Në vijimësi

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar Nj.A Farkë, 1 masa disiplinore, e cila është pranuar plotësisht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë

Nga verifikimi konstatohet se: Nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**.

Përmbledhëse e Masave

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pjesërisht (Pa filluar procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	11	11	0	0	11									
III	MASA SHPËRBLIM DËMI														
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV	MASA DISIPLINORE	1	1	0	0	1									
	(Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil														
V	MASA 3E														
	Nga të cilat:														
	Të ardhura të munguara														
	Dhe të tjera masa nëse ka Gjaba APP														
VI															

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në NJ.A Farkë, Bashkia Tiranë për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 796/31 prot., datë 16.06.2023, rezulton se subjekti i audituar **nuk ka respektuar** afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, por **ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, me shkresën me nr. 796/35, datë 12.02.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 796/31 prot., datë 16.06.2023, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësisë të rinj mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Farkë duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

2.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbyshur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

3.1. Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

4.1 Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë mos të pranohen kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës jashtë rrethit familjar të përfituesit të tokës bujqësore, ose pa pasur një prokurë të posaçme të trashëgimtarëve ligjor.

5.1. Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfitur tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

6.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa për saktësim harte, duhet të verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë, ndryshimet e ndodhura pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera.

7.1. Rekomandimi: Nëpunësi i zyrës së pritjes pranë Njësisë Administrative Farkë të pranojë kërkesa për vazhdimin e procedurës për regjistrim, të konfirmuar vetëm nga personi kërkues.

8.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa nga saktësim harte të shoqërohet me deklaratë noteriale me kufitarët e pasurisë që do të saktësohej.

9.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimit për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë”

10.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranë Njesisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur dokumentacioni shoqërohet me Relacion Shpjegues, kjo e fundit të protokollohet pranë zyrës së protokollit.

11.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së, të kërkoje nga poseduesi i tokës bujqësore vërtetimin nga zyra e taksave dhe e tatimeve për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

1. Rekomandim: Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËRORË TË KLSH-së

R.K (Përgjegjës grupi)

E.K

F.Ç

M.M

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K.Gj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2023 DERI 30.06.2022, NJËSIA ADMINISTRATIVE PETRELË,
BASHKIA TIRANË”**

Tiranë 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit	5
I/4. Metodologjia e Auditimit	5
I/5. Konkluzioni	5
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE PETRELË, BASHKIA TIRANË	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	8



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë”

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në 6 subjekte, respektivisht: Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Njësia Administrative Petrelë, Njësia Administrative Dajt, Njësia Administrative Farkë dhe Njësia Administrative Zall-Herr (Bashkia Tiranë): “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, kemi këtë situatë:

Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 796/32 datë 16.06.2023 **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh për dërgimin e planit të masave.

-2 masa organizative pranuar nga subjekti, rezultojnë pa zbatuar.;

-1 masë disiplinore, për të gjithë punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezulton e pazbatuar.

I/1. Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 191/7 prot., datë 20.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datë 25.03.2024, u krye auditimi në Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **R.K** - Përgjegjës grupi
2. **E.K** - Anëtare
3. **F.Ç** - Anëtar
4. **M.M** - Anëtar

Cështjet e Audituar:

1. Hartimi i programit (*Plan veprimt*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport përfundimtar auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë”

bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në NJ.A Petrelë me shkresën nr. 796/32, datë 16.06.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se NJ.A Petrelë nuk kanë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

